

KALLARATI



Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, nr. 113, Korrik - dhjetor 2024
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter Hysaj
Ky numër u sponsortizua nga:
Besnik Gjonbrataj



"TAKIMI I BREZAVE - 2024"/ Mirë se vini në Kallarati

Pas viteve 90-të, kur shumë gjëra ndryshuan, jo vetëm në drejtim sistemit politik, por edhe në jetën shoqërore, u krijuan si një formë e re bashkimi, shoqatat atdhetare e kulturore, të cilat në aktivitetin e tyre patriotik e kulturor programuan një lloj të ri aktiviteti që do të mbledhte dhe bashkonte të gjithë bashkëfshatarët një herë në vit duke e pagëzuar me emrin kuptimplotë "Takim Brezash", të cilat ato tashmë janë kthyer në aktivitete kulturore të përvitshme për fshatrat e luginës së Lumit të Vlorës, të Labërisë, por jo vetëm. Që nga krijimi i shoqatës Kallarati në vitin 2003, Takimet... Faqe 8-9



5 SHTATORI - "DITA E SHENJTËRIMIT E NËNË TEREZËS"



Faqe 3

GËZUAR VITIN E RI 2025!



Faqe 2

FJALË E DHËNË, PREMTIM
I MBAJTUR. GENTIAN
QEJVANAJ PËRFUNDON
AVENTURËN ME BIÇIKLETË
KINË - KALLARAT - VLORË



KUSH ËSHTË GENTIAN QEJVANAJ
Gentian Qejvanaj ka lindur në Vlorë në 31 gusht 1987 nga prindërit e tij Memo Qejvanaj dhe Zamira Isufi. Memua babai i Gentianit rrjedh nga një familje e thjeshtë dhe bujare kallaratase, i cili në një moshë të re u nda nga jeta duke punuar në sektorin e naftës dhe la pas dy fëmijë në moshë të mitur, Fatjon dhe Gentian Qejvanaj. Në kohën e ndryshimit të sistemit mamaja e Gentianit i mori dy fëmijët e mitur...

Faqe 12

NJË DITË NË
FUSHËBARDHË
NË KUJTIM TË
DËSHMORËVE
TË BETEJËS SË
SKËRFICËS - 1914

Faqe 7

GËZUAR VITIN E RI 2025!

Të dashur bashkëfshatarë kallaratas, kudo që ndodheni, miq e dashamirës të Kallararit!

Me rastin e ndërrimit të viteve, kryesia e Shoqatës "Kallarati" ju uron një Vit të Ri të lumtur, të begatë dhe plot shëndet e harmoni për ju dhe familjet tuaja!

Viti që po lemë pas ishte një vit i pasur me aktivitete kulturore dhe patriotike që na bashkuan dhe na bënë të ndihemi krenarë për rrënjët tona. Ndër këto aktivitete, veçojmë Piknikun Pranveror në "Fshatin e Djegur", "Takimin e Brezave" dhe shumë aktivitete e ngjarje të tjera që forcuan lidhjet mes nesh dhe trashëguan vlerat tona tek brezat e rinj.

Me shpresën dhe dëshirën që viti 2025 të jetë edhe më i frytshëm dhe të mbushet me aktivitete të reja që promovojnë historinë, traditat dhe kulturën e Kallararit, ju ftojmë të bashkoheni me ne për ta mbajtur gjallë këtë frymë të bashkimit dhe krenarisë kallaratase.

Gëzuar Vitin e Ri 2025!

Kryesia e shoqatës "Kallarati"



Punuar nga Vanesa Shytaj

110 – VJETORI I QËNDRESËS SË KALLARATIT NDAJ SULMEVE TË ANDARTËVE GREKË

Historia e Kallararit, është e mbushur plot me akte trimërie e heroizmi, ashtu si gjithë historia e trevës së Labërisë dhe e krejt Shqipërisë.

"Kallarati, fshat i paktë/ trima burrat, trime gratë"- thotë poeti.

Populli i Kallararit nuk e ka pranuar dhe nuk e ka duruar asnjëherë sundimin dhe pushtimin e huaj. Edhe në korrikun e 1914-ës, populli i Kallararit nuk mund t'i duronte dot andartët grekë, të cilët donin të pushtonin dhe shkatërronin fshatin tonë. Në këtë qëndresë dhanë jetën 5 dëshmorë Hyso Balil Xhaferaj, Murat Avdul Demiri, Çelo Maliq Boshi, Dervish Sali Maçi, Ramadan Hoxha dhe u plagosën shumë bashkëfshatarë të tjerë.

Kanë kaluar jo pak vite, por 110 të tillë dhe jeta, kontributi i tyre kujtohet me mjaft krenari, ashtu siç kujtohet jeta dhe vepra e gjithë dëshmorëve kallaratas të Luftës së 1920-ës, Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e deri te dëshmorët e fundit i periudhës së demokracisë, të cilët e kanë radhitur Kallaratin përkrah fshatrave të tjerë të Vlorës, Labërisë dhe krejt Shqipërisë si kontribuues i lirisë dhe pavarësisë së popullit tonë.



TROJA E LABËRISË — Nga Namik Jahaj

Krrakërimë,, ethe gjak Pabesia, veshur thinja Aq sa thek,, ke o shark Aq korba, dërgoi fqinja* Vrehet Çika,, nxin Bolena Çmënduri e hakërrima Kope klyshësh, me hijena T'mbarsur me vetëtima Gjuhë e flakës, dogji pyje Digjet Trojë* e Labërisë Pesë DRERË*, syrin me yje Bien këmban* e xhamisë... Feksi PIRRO,, kuqen retë "Braktis vatrat,, Kallarati" Tremben zogitë, lënë foletë Zemërimi del nga shtrati "Dëgjo,, Spiro Milo korbi Labi s'loz me ura zjarri Barut ndez çdo kokërr*loti Kockat t'i bën dhog'varri"... Dil pse s'del përpara Zotit Laj mëkatet shpirt'nxirë Nëse zbardhet pënd' e korbit Bëje "dasmën"...në Epir * * *

Vij pranë teje,, Bogonicë Buzën njom,, te kroi i Mirë S'di pse uji,, paska kripë Ndoshta loti është pashkrirë..? Zogu Gjon m'a heq mëzinë Brengë e tija diç më thotë Lere tymin,, të nxjerrë zinë Lere motin,, të derdhë lot... Vështroj yjet,, në këputje Ikin, kthehen,, bëhen fli Lemzë e trollit, bëhet lutje "Zot,, pse mbetëm pa çati,,?" Bogonicë,,ç'të zuri hera Përgjërhem,,kësaj nate Ç'janë ata,, të bukur drera Mos janë djemtë e Kallarate? Pranë legjendës, bijtë po vinë Pranë trollit,,që i lindi

Korb'hijanat,,le të nxijnë
TROJA NISI TË RILINDI

* Troja, (Kallarati vjetër);
rreth 100 shtëpi dykatëshe guri digjen nga andartët grekë, korrik 1914. Në këtë betejë, vriten pesë bij kallaratas.
* Fqinja...Greqia



Falënderojmë poetin dhe shkrimtarin nga Mesapliku, Namik Jahaj (që nuk është hera e parë që i kushton vëmendje Kallararit në krijimtarinë e tij artistike) për vizitën në "Fshatin e Djegur", ku edhe është frymëzuar për këtë poezi.

Kjo poezi përçon me forcë ndjenjën e krenarisë dhe dhimbjes për historinë e lavdishme të Labërisë dhe, në veçanti, të Kallararit gjatë ngjarjeve të vitit 1914, kur Kallarati i vjetër u përball me sulmin nga andartët grekë. Përmes vargjeve, autori paraqet një pamje të zymtë të pabesisë dhe dhunës, duke përdorur metafora të fuqishme si "korb'hijanat" dhe "kockat dhog'varri" për të përshkruar armikun dhe pasojat e tij shkatërruese.

Gjithashtu, duke përdorur elemente si Çika e Bogonica dy male që tregojnë qëndresën e fortë të fshatarëve ndaj sulmeve të andartëve grekë dhe simbolikën e "pesë drerëve" që përfaqësojnë pesë bijtë e rënë, poezia nderon sakrificën e bijve të Kallararit, të cilët dhanë jetën për të mbrojtur Trojën e tyre.

Strofa e fundit është veçanërisht e fuqishme, duke mbartur mesazhin e rilindjes dhe të qëndresës "Troja nisi të rilindi."

Poezia shpreh një ndjenjë të thellë për atdheun dhe trashëgiminë kulturore të Labërisë, me simbolikë të pasur që të fton të reflektosh mbi sakrificën dhe shpirtin luftarak të të parëve tanë.

(Shënim i redaksisë)



20 KORRIK, - “DITA E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR”

(Miratuar me ligjin nr. 67/2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”).

Në këtë ditë të shënuar, Kryesia e Shoqatës “Kallarati” uron gjithë ata kallarratas që gëzojnë Statusin e Veteranit të LANÇ-it ose pasardhës të tyre, si dhe gjithë veteranët shqiptarë kudo qofshin: “GËZUAR DITËN E VETERANIT TË LANÇ-it”



5 SHTATORI – “DITA E SHENJTËRIMIT E NËNË TEREZËS”

20 shprehje frymëzuese nga Nënë Tereza



- “Gjithmonë kur takohemi me njëri-tjetrin le të buzëqeshim, buzëqeshja është fillimi i çdo dashurie.”
- “Të duash do të thotë të bësh gjëra të vogla me dashuri të madhe.”
- “Mos i prisni kryetarët. Bëjini gjërat vetë, njëri për tjetrin.”
- “Fjalët e mira mund të jenë të shkurtra dhe të lehta për t’u thënë, por jehona e tyre është vërtetë pa fund.”
- “Vuajtja është dhuratë e madhe e Zotit.”
- “Duhet të flasim më pak. Një vend për t’u lutur nuk është vend për thashetheme.”
- “Unë nuk lutem për sukses. Kërkoj plotësinë e fesë.”
- “Nëse i gjykoni njerëzit, nuk keni kohë t’i doni ata.”
- “Folu butësisht njerëzve! Tregoje mirësinë në fytyrë, në sy, në buzëqeshjen tënde, në ngrohtësinë e buzëqeshjes tënde, gjithnjë të kesh buzëqeshje gazmore! Jep jo vetëm kujdesin, por edhe zemrën!”
- “Ne s’mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe.”
- “Nuk ka rëndësi sa shumë jemi të angazhuar të bëjmë, por sa shumë dashuri vendosim në të.”
- “Po prisja të isha e lirë, por Zoti ka planet e Tij.”
- “Çfarë mund të bësh për të promovuar paqen në botë? Shko në shtëpi dhe duaje familjen.”
- “Ne nuk kemi nevojë për armë dhe bomba që të sjellim paqe në botë. Kemi nevojë për dashuri dhe dhembshuri.”
- “Disa njerëz vijnë në jetë si bekim. Disa të tjerë vijnë si mësim.”
- “Nëse jeni të dekurajuar, kjo është një shenjë e krenarisë, sepse kjo tregon se keni besim në fuqitë tuaja.”
- “Jo të gjithë ne mund të bëjmë gjëra të mëdha. Por ne të gjithë mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe.”
- “Në qoftë se ne të vërtetë duam të na duan, duhet të mësojmë se si të falim.”
- “Dashuria fillon duke u kujdesur për më të afërmit.”
- “Varfëria më e tmerrshme është vetmia dhe ndjenja e të qenit pa dashuri”


1 TETORI – “DITA NDËRKOMBËTARE E TË MOSHUARVE” – “T’i duam dhe respektojmë të moshuarit”

Çdo vit, më 1 tetor, bota kremton “Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve”, një ditë e cila na kujton rëndësinë e jashtëzakonshme që kanë të moshuarit në familje e shoqëri. Të moshuarit janë dëshmitarë të një kohe të kaluar, të përpjekjeve dhe sakrificave që kanë bërë për të ndërtuar të ardhmen që ne sot gëzojmë. Përmes tregimeve të tyre, ne mësojmë për historinë tonë, kulturën dhe rrënjët që na lidhin me të kaluarën. Në këtë ditë, është më e rëndësishme se kurrë t’u tregojmë dashuri dhe respekt atyre që na kanë dhënë gjithçka pa kërkuar asgjë në këmbim. Kujdesi për të moshuarit është një detyrë që na përket të gjithëve, si pjesë e një shoqërie të bashkuar dhe humane. Për ta, nuk ka gjë më të rëndësishme se të ndihen të dashur dhe të respektuar nga brezat më të rinj.

T’i vizitojmë të moshuarit, gjyshërit tanë, t’i dëgjojmë me vëmendje dhe t’i kujtojmë ata se janë një pjesë e rëndësishme e jetës sonë. Të moshuarit meritojnë një pleqëri dinjitoze, të mbushur me dashuri, kujdes dhe mirënjohje. 1 Tetori na bën thirrje që të mos e harrojmë këtë mision të rëndësishëm dhe të kujtojmë se dashuria dhe respekti për të moshuarit, për gjyshërit tanë janë një pasuri e pashtershme, për të cilën duhet të jemi gjithmonë mirënjohës.

Në këtë ditë të veçantë, të gjithë të moshuarve kallarratas dhe të mbarë Shqipërisë kudo qofshin, ju urojmë “Shëndet, jetë të lumtur e pleqëri të bardhë”!





1942 - 18 TETOR - 2024

82 - VJETORI I RËNIES SË HEROIT TË POPULLIT MUMIN SELAMI DHE 4 HERONJVE TË TOPANASË

Në këtë përvjetor të 82-të rënies së Heroit të Popullit Mumin Selami, zgjedhëm për lexuesit, një shkrim të vitit 2016 të studiuesit, bibliografit, poetit dhe shkrimtarit Msc. Albert Habazaj nga Tërbaçi, kushtuar jetës dhe krijimtarisë letrare të heroit tonë, Mumin Selami.

“JETIMËT” – POEZI E PANJOHUR E NJË HEROI 19-VJEÇAR –

“Jetimët”, poezia e autorit dëshmor Mumin Selami, që botohet përherë të parë pas 75 vjetësh Mumin Selami u lind më 23 dhjetor 1923, në fshatin Kallarati të Kurveleshit të Poshtëm, Bashkia Himarë, qarku i Vlorës. Babai i tij Selam Bajram Toçi ka qenë burrë i respektuar, patriot, pjesëmarrës dhe drejtues në luftërat që ka zhvilluar populli i Kallaratis si kundër turqve e grekëve më 1914 dhe italianëve më 1920 në Vlorë. Ndërsa nëna e tij ishte deputetja legjendarë në Duzja me emër nderi në Labëri, Vlorë, Tiranë e më gjerë. Sipas kujtimeve të veteranëve e shkrimeve të bashkëkohësve, Mumin Selami ishte i pari në Kallarati dhe nga të parët në Kurvelesh, që ngriti zërin kundër fashizmit.

Për nderim të emrit të tij të artë dhe tre shokëve, që së bashku me të luftuan kundër 400 karabinierëve e tradhtarëve dhe ranë heroikisht natën e zezë të 18 Tetorit 1942 në shtëpinë e vogël, përdhese në Topana, që kish mure me kallama po u bë kala, publicisti dhe shkrimtari i njohur Kleo Lati ka botuar monografinë e shkëlqyer “Heronjtë e Topanasë”, Tiranë, 8 nëntori”, 1979, me 223 faqe, e cila fitoi dhe Çmimin e parë në konkursin letrar-artistik të shpallur atëherë për nder të 35 vjetorit të Çlirimit të Atdheut.


Nga historia kemi mësuar se të rinjtë Hajredin Bylyshi, Mumin Selami, Bajrami Tushi e Hiqmet Buzi – pjesëmarrës të Luftës ANÇ, Heronj të Popullit, natën e 18-19 tetorit 1942 u gjetën të rrethuar nga forca fashiste në një shtëpi në lagjen Tophana të Vlorës, bazë ilegale e PKS. Të rinjtë vendosën të çanin rrethimin dhe përmes zjarrit të dendur të armikut u sulën njëri pas tjetrit kundër fashistëve me revolver e bomba dore. Të katër u vranë duke luftuar. Akti i tyre pati jehonë jo vetëm në Vlorë, por në tërë Shqipërinë.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëll. 3, 2009, f. 2309-2310, na jep këtë portret: “Mumin Selami, veprimtar i Lëvizjes ANÇ, Hero i Popullit. Lindi në Kallarati të Vlorës. Gjatë kohës që ndiqte gjimnazin e Tiranës, përqafoi idetë komuniste”.

Pas pushtimit fashist të vendit u hodh në veprimtari dhe për këtë shkak u përfshiu nga shkolla, u burgos dhe u internua për më se një vit në fshatin e tij, ku vijoi veprimtarinë antifashiste. Me themelimin e PKS përqafoi vijën e saj dhe vazhdoi luftën kundër fashizmit e bashkëpunëtorëve të tyre, duke marrë pjesë në atentate të guximshme.

U arrestua e u burgos dy herë; në Tiranë e në Vlorë, iu nënshtrua torturave, por për mungesë provash u lirua. U vra më 18 tetor 1942

Dihet se Mumini është marrë me letërsi dhe njihet një vepër e tij letrare “Përlëshja e të vdekurve”. Në këtë shkrim ai i bën thirrje popullit të ngrihet kundër robërisë dhe shtypjes. Ai boton dhe vjershën “Mbi kockat e martirëve ngrihet atdheu”, 29 prill 1939. Kemi dijeni për një ditar të tij, nga i cili janë bërë të njohura shënimet e mbresëlënëse e të qarta: “27 Mars 1941” apo pjesa shkëputur nga “Loti i nënës”, gusht 1941. Në thelb Mumini qe poet revolucionar. Kishte nivel në krijimet e tij, ku dallon gjuha dhe shkrimi metaforik. Kemi shfletuar librin me poezi të autorëve dëshmorë “Flakëron me ngjyrë gjaku”,



Tiranë, “Naim Frashëri”, 1979, me 163 faqe, përgatitur nga Kristaq Shtëmbari, ku përfaqësohen 24 dëshmorë me vjershate tyre dhe përkatësisht (sipas rendit alfabetik) Ali Demi, Dino Kalenja, Dhimitër Mino, Faredin Xhindole, Gjistik Kuqali, Hamdi Mëzezi, Hasan Luma (Sufa), Jani Dodi, Jorgji Dilo, Kristaq Tutulani, Kristo Isaku, Margarita Tutulani, Memo Meto, Mihal Duri, Mustafa Radovicka, Myrteza Pengili, Nimete Progonati, Perlat Rexhepi, Qemal Stafa, Salo Halili, Sinan Ballaci, Sulo Didi, Xhafer Cenko Lubonja dhe Zaho Koka.

Emri i Mumin Selamit nuk është. E çuditshme, por ndoshta përgatitësi nuk ka mundur ta gjejë këtë vjershë të heroit që po publikojmë sot. Falënderojmë studiuesin e pasionuar të folkorit lab, ish – mësuesin e spikatur të gjuhëve të huaja në disa gjimnaze të Lumit të Vlorës, krijuesin e talentuar Llambro Hysi, i cili, duke i folur kujtesës së punës në terren të viteve 1970, duke gërmuar në arkivat e tij na prezantoi një vjershë të rrallë të poetit dëshmor Mumin Selami, e cila publikohet për herë të parë për lexuesin shqiptar të mbas 75 vjetësh. Është një poezi sociale, që shpreh talentin letrar të heroit të Topanasë, marrë nga gazeta “Tomorri”, e martë, 12 gusht 1941 me titullin “Jetimët” dhe nënshkrimin Mumin Selam KALLARATI”.

Ja teksti i plotë:

*E pashë që ra nga syt' e tu
Një lot i zjarrtë, i turbulluar,
Një lot që ngriu pa mbaruar
Rrugën që zu;
Dhe më erdhi keq, mik i ri,
O vogëlush fytyrë hënë,
Kur the që s'kam as babë, as nënë,
Jam pa njeri;
Kur the që dergjem në vetmi;
Nga gjithë shokët i veçuar,
Se unë jam një i mjeruar;
Pa pasuri;
Dhe tjetër lot nga syri ra,
Ja loti lotin e mbuloi,
Ja vdekja jetën skllavëroi
Trupi t'u tha...*

Kaq është poezia. 16 vargje me rima të mbyllura, që janë dhe të pasura, ku vargu i parë rimon me të katërtin dhe i dyti me të tretin, sipas skemës abba, që i japin muzikalitet poezisë. Pa u futur në morfologjinë poetike, vjersha “Jetimët” është drithëruese si realizim për gjetjen dhe mesazhet që jep. Është një pikturë në vargje që na vjen si reminishencë poetike e skulpturës “I urituri”, veprës së parë të të madhit Odhise Paskali (Torino, 1924). Te “Jetimët” e autorit Mumin Selami ndihet bukur ritmi harmonik, që të bën për vete në ato vargje

lakonike që ndriçojnë me dhembshuri, dashuri e humanizëm qytetar, me ngjyresë të freskët dhe origjinale artistike. Kur Llambro Hysi ma dha vjershën ta lexoja (e kishte palosur pjesën lart ku qe shkruar emri i poetit), më tha: “Lexoje me kujdes dhe më thuaj sa vjeç ka qenë autori kur e ka shkruar”. E lexova një herë, dy herë, tre. Më pëlqeu. Shumë. Pultja sytë. I thashë Llambros: “Ndoshta 50 vjeç. – Jo, jo – qeshte ai. “Lasgushi? Jo, Esenini? Jo. Lermontovi? Jo ... Ngjanin dhe s'ngjanin. Kur ma shpalosi kreun e fletës, shumë të vjetëruar dhe aq të zverdhur nga vitet dhe pashë emrin Mumin Selam Kallarati, sinqerisht u befasova deri në tronditje. Gati e pamundur. Por shumë e vërtetë. Imitim nuk ka, po ndoshta as ndikim s'besoj se ka, ngaqë në atë kohë Mumini s' ka patur mundësi të njëjhej me këto perla të letërsisë ruse. Nuk njëjhej në Shqipëri as Esenini, as Pushkini, as Blloku, as Lermontovi. Siç kemi lexuar, vetëm romani “Nëna” i Maksim Gorkit qarkullonte fshehurazi me fashikuj. Në vjershën “Jetimët” dallojmë formatimin e kulturës së gjerë të autorit, stilin e tij, thjeshtësinë dhe natyralitetin në të shprehurin e ndjenjës me romantizëm dhe realizëm, një gjuhë metaforike që të bën magji e të rrëmben për të mos e harruar tekstin, një pjekuri të dukshme artistike shumë të parakohshme. Dhe ishte vetëm 18 vjeç kur e shkroi. 19, kur u bë lule lirie...

VIZITË PRANË BUSTIT TË ADEM JASHARIT NË KOSOVË

Dy ish ushtarakë nga Kallarati me banim në Durrës, Xhelo TOZAJ dhe Gjergji DAUTAJ, në datën 12 tetor 2024, në përbërje të Shoqatës së Ushtarakëve në Rezervë të Durrësit, në kuadrin e 80 - vjetorit të çlirimit të atdheut, bënë një vizitë në Prekaz të Drenicës, Kosovë, te Memoriali i Komandantit Legjendar, Heroit të Kosovës, ADEM JASHARI, ku vendosën një buqetë me lule. Gjithashtu ata bënë një vizitë edhe në Muzeun e ngritur për familjen e Jasharëve.

Xhelo Tozaj në librin e vizitorëve la këtë shënim: “Jeta nisë me ditëlindjen dhe mbaron me ditëvdekjen, kurse për dëshmorët nisë me lindjen e më nuk pushon”.

Lavdi dëshmorëve të UÇK-së! Lavdi Heroit të Kosovës, Komandantit Legjendar, Adem Jashari!





Arsimi në Kallarat ka një histori të hershme, të pasur dhe domethënëse, që fillon në vitin 1916 me hapjen e shkollës, e cila më vonë do të merrte emrin e heroit të popullit, Mumin Selami. Kjo shkollë shërbeu si një vatër e rëndësishme për edukimin dhe formimin e breza të tërë nxënësish, të cilët sot e vazhdojnë trashëgiminë e saj me krenari.

Gjatë viteve, shkolla përjetoj sfida të shumta, përfshirë luftërat dhe ndryshimet politike që preken drejtpërdrejt edhe edukimin. Megjithatë, falë përkushtimit të mësuesve dhe mbështetjes së vetë komunitetit, shkolla arriti të konsolidohet vit pas viti dhe të arrinte standardet e duhura si gjithë arsimi në Shqipëri.

Mësuesit ishin figura kryesore që së bashku me përkujdesjen e familjeve ndikonin edukimin dhe arsimimin e fëmijëve kallarratas, duke u çelur atyre dyert e jetës dhe mundësitë për një arsimim tjetër më të avancuar të mesme apo të lartë.

Në vitin 2006, për shkak të rënies së numrit të nxënësve, shkolla jonë u mbyll dhe sot fëmijët e paktë kallarratas vijojnë arsimimin e tyre në Vranisht me transport të bashkisë.

Në këtë përvjetor të 108-të të shkollës që mban emrin e Heroit të Popullit Mumin Selami, shprehim vlerësim e mirënjohje për gjithë mësuesit kallarratas dhe të ardhur që me përkushtim kontribuuan në edukimin e fëmijëve kallarratas, duke ngulitur te ata dashurinë për dijeni, dashurinë për familjen e dashurinë për atdheun.

20 TETOR 1916 – 20 TETOR 2024 108 – VJETORI I ÇELJES SË SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË KALLARAT



22 NËNTORI – “DITA E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE”



22 Nëntori shënon “Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe”, një datë historike dhe e rëndësishme për identitetin dhe kulturën tonë kombëtare. Në këtë ditë, në vitin 1908, në Kongresin e Manastirit, u miratua alfabeti i gjuhës shqipe, i cili u bë një simbol i unitetit dhe i përpjekjeve për ruajtjen e gjuhës sonë amtare.

Le të kujtojmë dhe të nderojmë këtë moment të madh të historisë sonë duke vlerësuar gjuhën shqipe, këtë pasuri të çmuar që na bashkon si komb.





GËZUAR FESTAT E NËNTORIT!

*Të dashur bashkëfshatarë!
Me rastin e 28 dhe 29 Nëntorit, dy ngjarjeve madhështore në historinë tonë kombëtare, 112 - vjetorin e shpalljes së Pavarësisë dhe 80 - vjetorin e çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë, kryesia e shoqatës "Kallarati", Ju uron: "Gëzuar festat e Nëntorit!"*

Flamuri Kuq e Zi, që u ngrit në Vlorë nga Ismail Qemali dhe u mbrojti me gjakun e dëshmorëve, na kujton përherë se, liria dhe pavarësia janë fryt i sakrificave të mëdha e sublime të popullit shqiptar, ku edhe kallaratasit kanë qenë pjesë e këtij kontributi të rëndësishëm mbarëkombëtar.

**STAFETA E PATRIOTIZMIT TRASHËGOHET
TE BREZAT E RINJ.**


Marlis Lisandër Mataj nga Kallarati, më 28 nëntor 2024, në krye të një grupi fëmijësh vlonjatë duke mbajtur të valëvitur flamurin kombëtar.



NËNTOR 1944 - 4 NËNTOR 2024

80 - VJETORI I KONGRESIT TË PARË TË BGASH

NËNË DUZE BAJRAMAJ, DELEGATE E KONGRESIT TË PARË TË BGASH, MBAJTUR MË 4 NËNTOR 1944 NË BERAT



Midis 311 delegatëve të Kongresit të Parë të Bashkimit të Grave Antifashiste Shqiptare (BGASH), mbajtur në Berat më 4 nëntor 1944, ishte edhe Duze Bajramaj nga Kallarati, nëna e Heroit të Popullit Mumin Selami.

Kongresi i Parë i BGASH i bëri një analizë punës së kryer për realizimin e objektivave të LANÇ-it, u ndal në rolin dhe kontributin e gruas shqiptare, si një forcë e madhe aktive dhe përcaktoi detyrat që i dilnin BGASH pas çlirimit të vendit, për rindërtimin e Atdheut të shkatërruar nga lufta, për luftën kundër analfabetizmit e në përgjithësi për rritjen e rolit të gruas shqiptare në të gjitha fushat e jetës.

Ai i dha impulse të reja delegatëve të cilat do të përcilleshin në të gjithë masën e grave shqiptare për të realizuar detyrat e mëdha e të vështira. Mbas mbarimit të punimeve të Kongresit delegatët u ndanë me njëra-tjetrën me urimin "Mirupafshim në Shqipërinë e lirë".

Vendimet e Kongresit qenë historike, ato i dhanë një impuls Luftës ANÇ; qytete e krahina vazhduan të çlirohen njëra pas tjetrës, nuk vonoi shumë dhe Shqipëria u çlirua më 29 nëntor 1944.

NËNË DUZJA (Duze Bajrami), (1890-1961). Veprimtare e shquar e gruas antifashiste, deputete. Lindi në Bolenë, në familjen e Mingajve, dhe u martua në Kallarati me Selman Bajramin. Karakteri dhe shpirti luftarak i saj u sprovuan në LANÇ.

Ajo jo vetëm nuk u thye nga humbja e djalit, Mumin Selamit, por u bë një veprimtare e shquar e LANÇ-it në Lumin e Vlorës, duke u kthyer në një simbol të gruas antifashiste e atdhetare. Krijoi në fshat organizatën e gruas antifashiste, u zgjodh anëtare e Këshillit Krahinor të Kurveleshit dhe të Qarkut të Gjirokastrës. Pjesëmarrëse në kongresin e parë të Gruas Antifashiste në Berat, deputete në Kuvendin Popullor në dy legjislatura. U nda nga jeta më 31 maj 1961.



NËNË DUZJA (Duze Bajrami), (1890-1961). Veprimtare e shquar e gruas antifashiste, deputete. Lindi në Bolenë, në familjen e Mingajve, dhe u martua në Kallarati me Selman Bajramin. Karakteri dhe shpirti luftarak i saj u sprovuan në LANÇ. Ajo jo vetëm nuk u thye nga humbja e djalit, Mumin Selamit, por u bë një veprimtare e shquar e LANÇ-it në Lumin e Vlorës, duke u kthyer në një simbol të gruas antifashiste e atdhetare.

NJË DITË NË FUSHËBARDHË NË KUJTIM TË DËSHMORËVE TË BETEJËS SË SKËRFICËS - 1914

Me Fushëbardhën na bashkojnë shumë gjëra: Traditat e zakonet e labërisë, miqësia e kënga. Besoj se të gjithëve ju kujtohet vitin e kaluar pjesëmarrja e përfaqësuesve të kësaj shoqate dhe e grupit lab të Fushëbardhës në ceremoninë e organizuar në "Fshatin e Djegur", Kallarat për rifreskimin e pllakës përkujtimore të dëshmorëve të fshatit tonë të 1914-ës. Pra veç shumë gjërave si pjesë e labërisë, na bashkon edhe heroizmi dhe qëndresa ndaj andartëve grekë 110 vjet më parë, larë me gjak. Pikërisht në kujtim të kësaj qëndrese të përbashkët dhe në nderim të dëshmorëve të Skërficës, këtë fundjavë me një grup, anëtarësh të degës së shoqatës "Kallarati" të Tiranës e Fierit: Profesor Rami Memushaj, Kujtim Hysi, Bako Xhaferaj e Besnik Gjonbrataj, me ftesë të kryetarit të shoqatës së Fushëbardhës z. Nexhip Onjea morëm pjesë në përrurimin e memorialit kushtuar 9 dëshmorëve të Skërficës të vitit 1914.

Me këtë rast në emër të shoqatës "Kallarati" vendosëm një buqetë të freskët me lule ne mbishkrimin: "Lavdi dëshmorëve të Fushëbardhës, rënë në betejën e Skërficës, në mbrojtje të trojeve të Labërisë nga sulmet e andartëve grekë në vitin 1914".

Beteja e Skërficës është një gur themeli në historinë e popullit tonë, një akt heroizmi dhe sakrificë që frymëzon brezat e sotëm dhe të ardhshëm për të mbrojtur vlerat e kombit dhe lirinë. U ndjemë krenarë që ishim pjesë e kësaj përkujtimeje dhe bashkë me fushëbardhasit nderuam dëshmorët e atdheut.

Në emër të shoqatës "Kallarati", profesor Rami Memushaj bëri një përshëndetje të veçantë, ku pasi i falenderoi për ftesën e vuri në dukje bashkëpunimin e mirë midis dy shoqatave për evidentimin dhe ruajtjen e vlerave patriotike të Labërisë u ndal në mënyrë të veçantë kontributin dhe heroizmin e dëshmorëve të betejës së Skërficës në luftën e përbashkët të fshatrave të Labërisë për mbrojtjen ndaj qëllimeve shoviniste të Greqisë për aneksimin e jugut dhe ju uroj atyre suksese të mëtejshme në kryerjen e misionit të tyre në mbrojtje të vlerave të patriotizmit e të atdhedashurisë.

Aktiviteti ishte shumë i larmishëm me pjesëmarrje të gjerë, me fjalime, mesazhe, por edhe me këngë labe të grupit të njohur të Fushëbardhës dhe të grupeve të tjera të labërisë.

Shijua një drekë fushëbardhëse, mes njerëzve patriot, atdhetarë, mikpritësa e këngëdashës.

Falënderojmë organizatorët, kryetarin Nexhip Onjea për ftesën dhe mikpritjen e ofruar dhe ky bashkëpunim e kjo traditë e krijuar le të vazhdojë për një kohë të gjatë.

Lavdi të përjetshme dëshmorëve të Skërficës!

Lavdi dëshmorëve të 1914-ës, të gjithë fshatrave të Labërisë, rënë në luftë ndaj andartëve grekë!



Në emër të shoqatës "Kallarati", profesor Rami Memushaj bëri një përshëndetje të veçantë, ku pasi i falenderoi për ftesën e vuri në dukje bashkëpunimin e mirë midis dy shoqatave për evidentimin dhe ruajtjen e vlerave patriotike të Labërisë u ndal në mënyrë të veçantë kontributin dhe heroizmin e dëshmorëve të betejës së Skërficës në luftën e përbashkët të fshatrave të Labërisë për mbrojtjen ndaj qëllimeve shoviniste të Greqisë për aneksimin e jugut dhe ju uroj atyre suksese të mëtejshme në kryerjen e misionit të tyre në mbrojtje të vlerave të patriotizmit e të atdhedashurisë.



Pas viteve 90-të, kur shumë gjëra ndryshuan, jo vetëm në drejtim sistemit politik, por edhe në jetën shoqërore, u krijuan si një formë e re bashkimi, shoqatat atdhetare e kulturore, të cilat në aktivitetin e tyre patriotik e kulturor programuan një lloj të ri aktiviteti që do të mblidhte dhe bashkonte të gjithë bashkëfshatarët një herë në vit duke e pagëzuar me emrin kuptimplotë "Takim Brezash", të cilat ato tashmë janë kthyer në aktivitete kulturore të përvitshme për fshatrat e luginës së Lumit të Vlorës, të Labërisë, por jo vetëm.

Që nga krijimi i shoqatës Kallarat në vitin 2003, Takimet e brezave janë kthyer të përvitshme dhe si të vetmet mundësi të çmalljes me njëri tjetrin në vendlindjen e tyre, Kallarat. Ato mbartin e përcjellin dashuri, mall, nostalgji e krenari për të kaluarën, por edhe besim e shpresë për një të ardhme edhe më të mirë, më të bukur dhe më të gëzueshme për gjithë banorët e mbetur autoktonë në këtë zonë të lavdishme, që jetën e tyre e kanë lidhur pazgjidhshmërisht me pronën e tyre private, me natyrën e bukur të kësaj lugine e maleve hijerëndë në të dy anët e saj, me zhvillimin e blegtorisë, bujqësisë dhe kohët e fundit, falë rrugës automobilistike, optimist edhe për zhvillimin e turizmit.

Takimi i Brezave zhvilluar më 17 gusht në Kallarat shënon kulmin e aktiviteteve kulturore e atdhetare të shoqatës "Kallarat" për vitin 2024, i cili mblodhi në qendër të fshatit qindra vetë, ardhur nga çdo anë e globit ku jetojnë e punojnë sot kallaratasit.

Kush është larg atdheut, larg vendlindjes e ndjen më shumë se askush tjetër, mallin dhe dashurinë për të. Është kjo magji që e bën çdo njeri të tërhiqet si me magnet nga vendlindja e tij.

Vlora, Fieri, Saranda, Durrësi, Tirana e çdo qytet tjetër i Shqipërisë, por edhe Italia, Greqia, Anglia, Amerika e çdo vend tjetër, ku sot jetojnë kallaratasit janë të bukur, të ofrojnë mundësira të shumta për veten e familjen, por prapë si atdheu e vendlindja jote e mrekullueshme nuk janë, pasi malli dhe nostalgjia për to është e pakrahasueshme me asgjë tjetër.

*Ku i duket balta
m'ë e ëmbël se mjalta
-Në vend të tij.*

Kështu do të shkruante kohë më parë poeti ynë i Rilindjes, Çajupi. Pra edhe kallaratasve, "balta u duket më ëmbël se mjalta" në Kallarat në fshatin e tyre të lindjes e të origjinës.

Njohja e ruajtja e kulturës, traditave, zakoneve të fshatit e të Labërisë, forcimi i unitetit mes njëri - tjetrit e përcjellja te brezi i ri i dashurisë për vendlindjen, për rrënjët e familjes, për origjinën e të parëve të tyre, është mesazhi që këto takime përcjellin për komunitetin e këtyre anëve, sidomos për brezin e ri.

Prandaj ka vite që këto takime brezash në Kallarat, organizohen e mirëpritën nga të gjithë, se ato përçojnë emocion, bashkim dhe vlera pozitive te brezi i ri për të njohur e respektuar më shumë historinë, kulturën dhe traditat e vendlindjes.

Si përherë edhe këtë vit, më 17 gusht në Kallarat u mblodhën banorët e këtushëm, e ata të ardhurit nga qytete të ndryshme, Vlora, Saranda, Delvina, Himara, Fieri, Durrësi e Tirana, por

MIRË SE VINI NË KALLARAT! Welcome to Kallarat!



edhe nga jashtë vendit, Greqia, Italia, Franca, Anglia, Belgjika e deri nga Amerika e Kina e largët, për t'u takuar, çmallur e festuar së bashku në Takimin e Brezave.

U mblodhën ashtu një nga një të rinj e të reja, fëmijë e deri të të moshuarit, u mblodhën siç nëna mbledh në gjirin e vet fëmijët e saj.

U mblodhën në fshatin e tyre të lindjes, aty ku u rritën, shkolluan e dolën në jetë e pastaj u shpërndanë në çdo cep të Shqipërisë e anembanë botës, ku me zgjuars, zotësi, inteligjencë, punë e aftësi profesionale kanë ditur të çajnë në jetë duke bërë emër për veten e tyre, por në njëjtën kohë duke e bërë të njohur Kallarat in e duke rritur vlerat e tij, brenda e jashtë vendit.

U mblodhën në fshatin e tyre, plot histori e lavdi, në fshatin që ka nxjerrë figura të shquara në arsim, kulturë, shkencë, art e sport, në fshatin e

lindjes dhe origjinës së tyre, në Kallarat in e tyre të dashur, i cili i bën krenar kudo që janë, kur thonë me plot gojë "Jemi nga Kallarat".

U mblodhën aty nipër e mbesa, ata të cilët e ndjejnë gjithnjë e më shumë dashurinë për vendin e origjinës së prindërve e gjyshërve të tyre.

U mblodhën me një dëshirë e nostalgji për të kujtuar të kaluarën, fëmijërinë, vuajtjet e sakrificat, por edhe harmoninë, dashurinë, besën dhe mikpritjen.

U mblodhën për të njohur gjurmët e të parëve të tyre, sepse dashuria për atdheun është mbi gjithçka.

U mblodhën të gjithë nën moton e njohur tashmë për këdo "Ec ngado, po Kallarat in mos e harro"!

U mblodhën, dikush për të parë edhe mundësinë e kthimit për gjithmonë, apo të investimit në





gjyshi, 90 - vjeçari Abaz Dautaj e deri te fëmija i tij i vogël. Në nder e respekt të miqve nga Kosova, Bislim Bislimit dhe Bedri Zyberaj grupi lab i përshëndeti me këngën kushtuar heroit legjendar Adem Jashari. Z. Bedri Zyberaj në emër të miqve të ardhur nga Kosova, pasi falënderoi shoqatën "Kallarati dhe banorët e tij për pritjen e ngrohtë e tepër vëllazërore, interpretoi me shumë profesionalizëm një poezi të Fishtës, e cila ngjalli mjaft emocione dhe u shoqërua me duartrokitje të fuqishme.



Poetja Lela Qejvani, e frymëzuar nga pjesëmarrja në takimin e brezave në Kallarati, drekt shkroi vargjet e mëposhtme:

*Kallarati fshati me vlerë
Se ç'e tunde këtë here
Këngë e valle napoloni
Katjushkën dhe pogonishten
Populloren labërishten
Seç gjëmon Bogonica
Grykë e Shurit dhe Shushica
Dridhet toka nën këmbë
Nga meloditë me shumë ngjyra
Shkon deri tek Mitrovica
Adem Jashari e Shote Galica
Heronjt të gjallë si tund zbatice.
Kallarati o fshati i rrallë,
Gjelbërim edhe stërrall,
Me poet edhe shkrimtar,
Heronjtë i kishe të rrallë
Grekut se ç'i bëre ballë.
O Kallarati me valë!*

Kryetari i bashkisë së Himarës, Z. Vangjel Tavo në faqen e tij zyrtare, me rastin e zhvillimit të takimit të brezave në të gjitha fshatrat e Lumit të Vlorës, pjesë e kësaj bashkie, uroi të gjitha fshatrat, duke përfshirë edhe Kallaratin. Ndërmjet të tjerash në urim thuhej: "Shpreh mirënjohjen e thellë për të gjitha shoqatat kulturore të fshatrave që e organizojnë me devotshmëri çdo vit një festë të tillë kaq të bukur, e cila tashmë konsiderohet një traditë e çmuar që na krenon të gjithëve dhe ushqen brezat e rinj me dashurinë për vlerat e rralla të vendlindjes.

Ju uroj ta kaloni sa më gëzueshëm në emër të traditës, bashkimit dhe harmonisë!"

Takimi i brezave vazhdoi gjatë gjithë natës deri në orët e para të mëngjesit të datës 18 gusht me këngë e valle të muzikës popullore dhe ato labçe në çdo tavolinë.

Në fund moderatorja e takimit Anxhela Hysaj, e cila e moderoi mjaft bukur këtë aktivitet kulturor të takimit të brezave u shpreh:

Të dashur pjesëmarrës!

TAKIMET E BREZAVE



*"Ju uroj ta kaloni sa më gëzueshëm në emër të traditës, bashkimit dhe harmonisë!"
Vangjel Tavo*

Besoje se kënduam e kërcyem dhe kaluam një mbrëmje të veçantë dhe tani erdhi momenti dhe koha që këtë aktivitet ta mbyllim për sonte.

Faleminderit pjesëmarrësve!

Faleminderit banorëve të Kallaratis për mikpritjen! Faleminderit shoqatës dhe këshillit të fshatit për organizimin kaq bukur të këtij takimi.

Faleminderit këngëtarëve dhe orkestrës fantastike! Faleminderit miqve nga Kosova dhe Tirana, Mirë u takofshim në aktivitete të tjera.

Nga unë Anxhela Hysaj, Ju roj Natën e mirë!

Përgatiti për gazetën: Besnik Gjonbrataj

fshatin e tyre të bukur, piktoresk buzë Shushicës, anës rrugës automobilistike, në këtë fshat të Lumit të Vlorës, të lakmuar tashmë edhe nga turistët e huaj.

Dhe Kallarati i priti krahëhapur me bujarinë e tij, siç di nëna të presë fëmijët e vet, ashtu siç ka ditur t'i presë çdo vit.

Por Takimi i brezave të këtij viti, përveç aspektit kulturor ishte i ndërthurur fare mirë edhe me aspektin patriotik e historik dhe kjo falë pjesëmarrjes së miqve nga Kosova e Tirana, drejtuesve të dy institucioneve të rëndësishme mbarëkombëtare të arkivave shtetërore, atë të Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilët pranë lapidarit të fshatit ekspozuan disa stenda me fotografi me veshje të hershme të krahinës së Kurveleshit, si dhe të disa dokumenteve arkivore të Kallaratis, të cilat u ndoqën me interes nga pjesëmarrësit.

Por më mbresëlënëse për miqtë nga Kosova ishte vizita në fshatin e djegur, atje ku 110 vjet më parë andartët grekë e plaçkitën dhe e dogjën "Trojën e Vogël labe" siç quhet me të drejtë. Atje ata panë me sytë e tyre masakrën e bërë 110 vjet më parë, e cila u sollë në kujtesë masakrat dhe gjenocidin serb ndaj Kosovës.

Në këtë vizitë miqtë u njohën dhe panë nga afër Kallaratin e dikurshëm, vendosur në pllajën e bukur të Pilingrisë, me arkitekturë të veçantë të ndërtimit të tij, si rrallëkush fshat tjetër në zo-



nën e Kurveleshit, i cili në korrik të vitit 1914 u martirizua e u dogj nga andartët grekë. Banorët, pas një qëndrese me armë, ku u vranë 5 veta e u plagosën 6 të tjerë, u detyruan të shpërngulen prej këtu e të strehohen në fshatrat fqinjë e më vonë të ndërtojnë shtëpitë pak a shumë aty ku janë sot në tre lagje, njëra më e bukur se tjetra.

Fshati u dogj, por historia mbeti atje, në këto troje që sot njihen me toponimin "Fshati i Djegur". Lapidari, me pllakën në të cilën janë skalitur emrat e 5 dëshmorëve të Atdheut: Murat Avdulit, Çelo Boshit, Hyso Baliliz, Dervish Maçit e Ramadan Hoxhës, na kujton pikërisht këtë qëndresë e histori të lavdishme.

Vizita e këtyre dy personaliteteve kryesorë të evidentimit e ruajtjes dokumentare të historisë tonë kombëtare, le të shërbejë edhe si një ndihmesë për t'i dhënë këtij fshati statusin ligjor të një "Qendre Historike" të mbrojtur nga shteti si trashëgimi kulturore, status të cilin e ka merituar me kohë.

Pas grumbullimit të të gjithë të ardhurve, miqve e shokëve të ftuar, kur akrepat e orës

shënuan 19:30 erdhi çasti i mirëpritur i fillimit të Takimit të Brezave, i cili këtë vit, ashtu si edhe 8 vite më parë në festimin e 100 vjetorit të çeljes së shkollës së parë shqipe në Kallarati, iu besua vajzës simpatike kallaratare, Anxhela Hysa. Si gjithmonë takimi filloi me ekzekutimin e Himnit Kombëtar.

Para një viti, falë sponsorizimit të djemve të Kallaratis ky shesh gjëmoi nga muzika dhe kënga e këngëtares Maja Aličkaj, Ermira Kola e Gjergji Leskaj. Ndërsa sivjet në këtë takim brezash falë sponsorizimit të Këshillit Bashkiak të Himarës, patëm mes nesh dy këngëtarë të dëgjuar të muzikës popullore të jugut, ALTIN BASHO nga Gjirokastra dhe IRINI BELERI, vajza e këngëtares së njohur të Grupit të Himarës Katina Beleri.

Gjithashtu, kësaj mbrëmje me dëshirën e tij, dy këngëtarëve iu bashkua edhe një tjetër artist, tashmë i njohur në Shqipëri, por veçanërisht në Greqi, banori i Kallaratis e biri i Bolenës, fyelltari Siri Sadikaj. Këngëtarin Zeqo Hoxhaj jemi mësuar ta shohim e dëgjojmë me këngën e tij të famshme "Çu këputë një këmbë mali", kënduar në festivalin folklorik të Gjirokastrës në vitin 1983. Por kënga e talenti i Zeqos është trashëguar te fëmijët, pikërisht te djali i tij Renato Hoxhaj, ardhur enkas nga Gjermania për të festuar së bashku, por edhe për të kënduar labçe. Ai sollë në këtë takim dy korifejtë e këngës labe, dy "Mjeshtrat e Mëdhenj" Nazif Çela, Vendim Kapaj, e grupin të cilët na dhuruan emocione të veçanta.

Ashtu siç ishte parashikuar në program aktiviteti vijoi me këngë e valle, ku binte në sy prania e brezit të ri. Mjeshtri i madh, Vendim Kapaj, fyelltari i talentuar i Labërisë, i cili vinte për herë të parë në Kallarati përshëndeti pjesëmarrësit me një melodi me fyell, e cila u prit me shumë duartrokitje. Më tej moderatorja Anxhela Hysaj ftoi kryetarin e Shoqatës z. Kastriot Karabollë e sekretarin e shoqatës z. Hasan Mehmetaj për të dhënë "Certifikatë Mirënjohje", dy të rinjve, që edhe pse nuk kanë lindur në Kallarati, ruajnë dhe respektojnë si gjënë më të shtrenjtë, dashurinë për vendlindjen e gjyshërve dhe të prindërve të tyre, dy të rinj që premtimin e dhënë para një viti e bënë realitet: Të parin, ciklistin, Gentian Qejvanaj, që me aventurën e tij me biçikletë Kinë - Kallarati ngriti më lart nderin e krenarinë e Kallaratis.

Po me "Certifikatë Mirënjohje", për kontributin vullnetar të dhënë për ndriçimin e qendrës së fshatit, u vlerësua edhe inxhinieri Gerald Dautaj, që edhe pse ka lindur në Durrës, në çdo festë është i pranishëm në Kallarati familjarisht 4 breza, nga



MIQTË NGA KOSOVA DHE TIRANA, VIZITË NË "FSHATIN E DJEGUR" DHE PJESËMARRRËS NË "TAKIMIN E BREZAVE"

Të ndodhur për pushime në jug të vendit, më 17 gusht z. Ardit Bido, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë, z. Bislim Bislimi - drejtori i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe disa shokë e miq të tyre morën pjesë në aktivitetin e "Takimit të Brezave", organizuar në mbrëmje në qendër të fshatit.

Por në mbrambashten e kësaj dite, ata bënë një vizitë në "Fshatin e Djegur", ku panë dhe u njohën nga afër me këtë "Troje Labe", djegur nga andartët grekë në korrik të vitit 1914. Ata panë nga afër rrënojat e këtij fshati të martirizuar nga andartët grekë si dhe u njohën me qëndresën heroike të banorëve të fshatit tonë në këtë luftë, por në përgjithësi në të gjitha përballjet me pushtuesit e huaj, ku dhanë jetën 27 dëshmorë të atdheut.

Vizita e z. Bido pasonte një sërë daljesh të tij publike në media, që me fakte historike pati vërtetuar pasojat e sulmeve të andartëve grekë ndaj fshatrave të Labërisë, një nga këto edhe Kallarati dhe hedhur poshtë pretendimet e qarqeve të caktuar shoviniste greke për të ashtuquajturin "Vorio Epir". Ai vizitoi "Fshatin e Djegur" vetëm nën kujdesin e shoqatës "Kallarati", edhe pse kolegëve të tij gazetarë e analistë u kishte bërë ftesë publike në media, për të vizituar së bashku fshatrat e prekur nga këto sulme.

Vizitorët, miqtë e Kallarati tashmë, sidomos kosovarët, u mahnitën me pozicionin gjeografik të "Fshatit të Djegur", natyrën e bukur dhe njerëzit fisnik të fshatit. Si drejtues të institucione që merren me trajtimin e njohjes e gjurmimit të fakteve e dokumenteve të historisë së kombit shqiptar shprehën mendimin që, nëpërmjet institucioneve



shtetërore, vetë fshati, por edhe pushtetit lokal, të kërkojë shpalljen me ligj të "Fshatit të Djegur" në "Zonë Historike" të mbrojtur nga shteti, gjë e cila do të bëjë të mundur edhe zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

Përpara fillimit të aktivitetit të "Takimit të Brezave", Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave

të Shqipërisë para lapidarit ekspozoi disa stenda historike të krahinës së Kurveleshit dhe në vijim miqtë e ardhur festuan së bashku me banorët dhe kallaratasit e ardhur. Për nder të miqve nga Kosova, u ngritën dolli dhe u falënderuan për vizitën e bërë. Miqtë nga Kosova u përshëndetën me një këngë labe kushtuar



Heroit Kombëtar Adem Jashari, kënduar nga "Mjeshtri i Madh" Nazif Çela, Vendim Kapaj, Renato Hoxha e grupi. Nga ana e tyre, z. Bedri Zyberaj në emër të shokëve, falënderoi për ftesën, vlerësoi mikpritjen kallaratare dhe recitoi disa vargje të Fishtës, të cilat sollën mjaft emocione për të pranishmit.

MBRESAT E NJË KOASOVARI PËR VIZITËN NË JUG TË SHQIPËERISË DHE NË VEÇANTI NË KALLARAT

Poeti, shkrimtari dhe studiuesi nga Kosova, Bedri Zyberaj, lidhur me pjesëmarrjen në "Takimin e Brezave" në Kallarati në fejsbukun e tij shkruan: "Në saje të miqësisë me Ardit Bido, Ardit Çela, Marjush Seitaj dhe Ergi Zaloshnja përgjatë datave 15, 16, 17, dhe 18 gusht të këtij viti, së bashku me Bislim Bislimin, patëm mundësinë (për të satën herë) të shijojmë ngrohtësinë dhe bukurinë e plazheve të Borshit e Jalit, por dhe të vizitojmë fshatrat e asaj zone: Pilurin dhe Qeparoin lartësitë e të cilave të ofrojnë pamje prej ballkoni të Himarës me rrethinë dhe Detit Jon.

Këto i kisha provuar dhe shijuar edhe më parë, pasi në Pilur kisha qenë disa herë deri tani. Megjithatë, bukuria që ofrojnë ato maja ku këto fshatra janë të ngulitura për t'i qëndruar besnikërisht tokës dhe qiellit, për mua është përherë diçka e pa përsëritshme.

Ajo që ishte më e veçantë për mua këtë radhë, ishte udhëtimi nga Qeparoi për në fshatrat e Luginës së Vlorës: Kuç, Kallarati, Vranisht. Në pasditen e 17 gushtit, pasi përshkuam rrugën gjarpërore përmes malesh dhe grykash, diku pas orës 15:00 arritëm poshtë fshatit Kuç ku ishte një restorant dhe na priste z. Besnik Gjonbrataj me zonjën e tij Luizën - profesoreshë e Gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Sapo të takosh këtë çift, gjëja e parë që të bie në sy është një zotnillëk pa as më të voglën shtirje. I kishin ndërmarr të gjitha masat për të na dhënë një drekë sa më të mirë, ku mjeshhtërisë dhe artit të kulinarisë së asaj zone ia shtonte vlerën edhe një krua aty afër tavolinës që kishte një ujë të ftohtë që kur e pije, të binte në ballë siç themi në këto anët tona.

Pasi mbaruam me drekën që na shijoi aq shumë, tani, të shoqëruar edhe nga çifti Luiza dhe Besnik Gjonbrataj, u ngjitëm lartë në Kuçin e Zenel Gjolekës - njërit nga ata "ditëzinj", që nuk luftuan as për mua as për ty, po për gjithë Shqipëri".

Kur u gjenda përballë përmendores së tij, provova një ndjenjë afërsie të veçantë. Më dukej se ai trim ishte më shumë i imi se i fshatit dhe zonës së tij. Që andej nuk mund të kthehesha pa e ndezur një cigare. Duke thithur tymin e saj, shikimi më zhvendosej sa nga Gjoleka sa në malet e larta që e rrethonin atë zonë dhe që dukeshin se po e shikonin Zenel Gjolekën si me zili për madhësinë



e mitit të përjetësisë së tij që ua përcjell brezave të njëpasnjëshëm.

Nga aty, siç ishim të gjithë së bashku, vazhdojmë rrugën për në Kallarati.

Në qendër të Kallarati, ku në mbrëmje do të mbahej festa e fshatit "Takimi i Brezave" takuam disa banorë me të cilët u përshëndetëm dhe i uruam për festën.

Z. Gjonbrataj i kishte ndërmarr masat që të na siguronte transportin për në Kallaratin e djegur në

vitin 1914 nga Spiromiloja.

Kur arrijmë atje, gjejmë gërmadhat e një fshati të djegur para 110 vitesh, nga andartët grekë dhe një përmendore ku janë të shënuar emrat e të rënëve në atë luftë të pabarabartë. Nga pozita ku ishte i vendosur dhe gërmadhat e shtëpive që kanë arritur t'i mbijetojnë shekullit të parë të jetës së tyre, nuk është e vështirë të konstatojmë se ishte në fshat i bukur me planimetrit, me rrugë të shtruara me kalldrëm dhe shtëpi dykatëshe, po ashtu të bukura.

Në mbrëmje, pasi zumë vendet, filloi kënga dhe vallja. Kuptohet, më therësja ishte kënga polifonike që i kushtohet Kallarati dhe trimave të asaj ane dhe arrijnë deri te Adem Jashari në Prekaz.

Po çfarë të thuhet për mikpritjen labe?! S'ka si ajo!

Le pastaj dollitë e njëpasnjëshme që të shoqërojnë përgjatë gjithë kohës sa je aty.

Me këdo që takohesh më dukej sikur njihesha që moti.

Prandaj, dua dhe një herë që t'i falënderoj të gjithë ata kallaratas që ishin aty, pavarësisht në u ngjatjetuam apo jo, dhe ata që tani janë shpërndarë në anë të ndryshme të botës.

Dua të përshëndes dhe të falënderoj shoqatën "Kallarati" dhe posaçërisht çiftin Luiza dhe Besnik Gjonbrataj, si dhe Bako Xhaferaj!

Tani Kallarati i ringritur në breg të lumit Shushicë, për inat të djallit dhe të armikut, për çdo të shtune të mesme të gushtit të çdo viti, organizon dhe feston festën "Takimi i Brezave", bukurinë e të cilës, këtë herë, pata fatin ta shikoja dhe shijoja edhe unë.

Ju paça të gjithëve!

P.S. Do të ishte një gjë e mirë dhe me interes që në Kallaratin e djegur të bëhej një investim për një Muze të hapur, të cilin, përveç banorëve të asaj ane, do të mund të vizitonin edhe turistët e huaj, numri i të cilëve sa vjen e po rritet për turizëm malor dhe historik

XHELO TOZAJ- MBRESA NGA TAKIMI I BREZAVE MË 17 Gusht 2024 NË KALLARAT

Mbretëronte lapidari i 26 dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me bustin simbol të birit të Kallarati dhe nipit të Bolenës, Mumin Selami. Takimin e bënte krenar edhe ekspozita kushtuar Labërisë, e hapur grupi i arkivit të shtetit që e kryesonte drejtori z. Ardit Bido, i cili nderohej edhe nga një grup i Arkivit të Kosovës, kryesuar nga drejtori i tij z. Bislim Bislimi, të cilët kishin vizituar zemrën e Labërisë, Himarën me fshatrat e bregut, Kuç e e qëndruan në Kallarati. Ekipet vizituan fshatin e djegur nga andartët grekë në 1914, ku bënë homazhe edhe në pllakën përkujtimore kushtuar 5 dëshmorëve që dhanë jetën për mbrojtjen e fshatit. Kjo vizite u kurorëzua me një video nga zoti Bido, shoqëruar me foto të ndryshme. Respekt për dy grupet dhe drejtorët e tyre të rinj në moshë, por shumë institucional. Në respekt të aktit të tij ishte ekspozuar dhe portreti i djalit që udhëtoi me biçikletë nga Kina në Kallarati. Kishte të ardhur në takim nga vende të ndryshme e mosha të ndryshme. Ishte edhe 90 - vjeçari Abaz Dauti nga Durrësi, ndonëse me probleme shëndetësore, por krenar për faktin që djali i tij Gjergji me dy djemtë e rij inxhinier bënë edhe ndriçimin e qendrës së fshatit me kontribut vullnetar.



Fshati Kallarati historikisht ka pasur peripeci, por ka qëndruar në këmbë, ra kolera e humbën shumë jetë nga epidemia, e ndërtuan fshatin modern për kohën, por u desh të derdhnin gjak për ta mbrojtur nga grekët, të cilat i vunë flakën duke e rrafshuar. Përsëri u vendos fshati në dy anët e Lumit Shushica duke kaluar valën e luftës së pare e të dyte me rol aktiv deri në çlirimin e vendit duke u përshtatur reformave të kohës me një jetë kolektive të centralizuar por me një jetë normale social - kulturore, me shkolla, ambulance me mjek, maternitetet e vatër



kulture etj. Nga kjo shkollë kanë dal qindra kuadro që drejtuan jetën në fshatra e sot bëjnë emër në botë. Ndryshimi i sistemit si në gjithë Shqipërinë e vuri fshatin në provë dhe rrugë të vetme gjeti eksodin duke mbetur vetëm disa pleq në fshat. Vlen të falënderoj Zeqo Hoxhën, i cili mban gjallë fshatin me lokalitë e tij, që i pret dhe i përcjell me këngë.

Shpëtim për lumin e Vlorës është rruga, e cila do sjell gradualisht zhvillim të ri duke u lidh me bregun. Komplimente shoqatës "Kallarati" me kryetarin e saj që na mban të informuar nëpërmjet fejsbukut, që shpirtërisht ndodhemi afër njeri-tjetrit në gëzime e hidhërimet. Të ecim me moton "Ecnì ngado, por Kallaratin mos e harroni".

FALËNDERIM I KRYESISË SË SHOQATËS "KALLARATI" PËR TAKIMIN E BREZAVE TË DATËS 17 GUSHT 2024

Të dashur bashkëfshatarë!

Ashtu siç ishte paralajmëruar prej muajsh më parë, në datën 17 gusht 2024 në një atmosferë tepër festive në Kallarati u zhvillua me sukses "Takimi i Brezave".

Kryesia e shoqatës "Kallarati" në përfundim të takimit falënderon:

Gjithë pjesëmarrësit, banorët vendas, të ardhurit nga çdo qytet i Shqipërisë dhe emigrantë, në mënyrë të veçantë të rinjtë e të rejat, që e gjetën mundësinë dhe morën pjesë, gjë e cila shpreh dashurinë që kallaratasit kanë për vendlindjen dhe origjinën e të parëve të tyre.

Kryetarin e bashkisë së Himarës, Z. Vangjel Tavo, që në faqen e tij zyrtare përshëndeti fshatrat e Lumit të Vlorës me rastin e zhvillimit të takimit të brezave, midis tyre edhe Kallaratin.

Këshillin bashkiak të Himarës që bëri të mundur sponsorizimin e këngëtarëve Altin Basho dhe Irini Beleri.

Miqtë nga Kosova: z. Bislim Bislimi, drejtori i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Z. Bedri Zyberaj, drejtori i Departamentit dhe ish drejtor i Arkivave të Kosovës për praninë e tyre takimin e brezave dhe vizitën në "Fshatin e Djegur".

Studiuesin dhe analistin e dëgjuar, Ardit Bido, njëkohësisht Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë, si dhe zotërinjtë: Ardit Çela drejtor në TV News 24, z. Ergi Zaloshnja e Marjus Seitaj, punonjës në Arkivin e Shtetit, për vizitën në "Fshatin e Djegur", për çeljen e ekspozitës me fotografi të vjetra të veshjes në krahinën e Kurveleshit, si dhe për pjesëmarrjen në "Takimin e Brezave".

Këngëtarët Altin Basho dhe Irini Beleri dhe orkestrën, që e ndezën flakë sheshin në qendër të Kallaratis. Renato Hoxhaj për përgatitjen dhe paraqitjen e grupit të këngës labe me pjesëmarrje të "Mjeshtrove të Mëdhenj" Nazif Çela, Vendim Kapaj etj, për emocionet që krijuan me këngët e kënduara me aq pasion, për përshëndetjen e veçantë për miqtë nga Kosova me këngën për heroin legjendar Adem Jashari.

Siri Sadikaj që me fyellin e tij solli melodi mahitëse duke i dhënë vlera takimit të brezave.

Anxhela Hysaj, që moderoi dhe i dha edhe më shumë vlerë "Takimit të Brezave".

Sponsorizuesit e takimit: Bako Xhaferaj, Aranit Rjepaj, Miri Ribaj, Luli Xhaferaj, Selman Memushaj, Robert Mehmetaj.

Bizneset private të fshatit për shërbimet e afuara.

Gerald e Gjergji Dautaj me shokët e tyre durrsakë për ndriçimin e qendrës dhe të rrugëve kryesore të Morrezes.

Gratë e fshatit në angazhimin e tyre për gatime tradicionale.

Burrat, gratë, djemtë e vajzat që u angazhuan në detyra të ndryshme për zbukurimin e qendrës së fshatit, për transportin për në "Fshatin e Djegur" dhe detyra të tjera për mbarëvajtjen e takimit si: Luto Demiri, Lefter Hysaj, Elena Memushaj, Aranit Rjepaj, Bako Xhaferaj, Miri Ribaj, Myzafer Qejvani, Lili Memushaj, Myzafer Laçi, Bardhi Muharremi, Bastri Gjonbrataj, Lela Qejvani, Vangjel Ribë, Ibrahim Goxhaj, Lavdosh Bejti, Fejzi Xhaferaj, Elidon Hoxhaj, etj.

Falënderojmë edhe gjithë banorët e tjerë me kryetarin e fshatit, Bashkim Davaci për masat e marra për pritjen e realizuar të gjithë të ardhurve.

Ekspierenca e fituar le të shërbejë për takimin e vitit tjetër, për të cilën kërkohmë angazhim më të madh nga të gjithë.

Kryesia e shoqatës "Kallarati"



FJALË E DHËNË, PREMTIM I MBAJTUR. GENTIAN QEJVANAJ PËRFUNDON AVENTURËN ME BIÇIKLETË KINË - KALLARAT - VLORË



NGA BESNIK GJONBRATAJ

KUSH ËSHTË GENTIAN QEJVANAJ

Gentian Qejvanaj ka lindur në Vlorë në 31 gusht 1987 nga prindërit e tij Memo Qejvanaj dhe Zamira Isufi. Memua babai i Gentianit rrjedh nga një familje e thjeshtë dhe bujare kallaratase, i cili në një moshë të re u nda nga jeta duke punuar në sektorin e naftës dhe la pas dy fëmijë në moshë të mitur, Fatjon dhe Gentian Qejvanaj. Në kohën e ndryshimit të sistemit mamaja e Gentianit i mori dy fëmijët e mitur dhe emigroi në Itali. Me sakrificë dhe përkushtim ajo i rriti edukoi dhe shkolloi dy djemtë e saj që u diplomuan në shkollat e larta Italiane.

Gentiani u diplomua në Itali për Shkenca Politike, ka kryer masterin në Bruksel. Gjithashtu ka punuar një vit në Parlamentin Evropian. Mbas mbaroi masterin ai shkoi në Kinë ku vazhdoi të studionte dhe të diplomohet me PhD (doktoraturë) në çështjet publike me një studim krahasues midis Shqipërisë dhe Kinës.

Gentit nuk i mjaftoi karriera akademike, por vazhdoi të merret me aktivitete sociale dhe sportive që zhvillohen në Kinë, ku doli fitimtar dhe mori çmimin e parë në disa maratona kineze, si edhe lartësoi flamurin shqiptar në çiklizëm. Ai vazhdon të promovojë Shqipërinë dhe kulturën shqiptare në Kinë, duke u përpjekur të jetë një urë lidhëse midis dy vendeve.

FJALË E DHËNË PARA NJË VITI,



jashtë e duke përmendur Kinën - mendja më shkoi te Gentiani. Sapo Lela përfundoi fjalën e saj - i them, ku është Gentiani? Me të përkrahu i afrohem tavolinës së madhe ku ishte vendosur fisi Qejvanaj dhe menjëherë dallova portretin e Gentianit, veshur sportiv. Pa u përshëndetur e pa u prezantuar fare me të, ngaqë moderatorja Anila ishte duke pritur këngëtarën Maya

pasioni i tij mbetet "aventura" nëpërmjet çiklizmit, ecjeve të gjata në terrene të vështira, si dhe ndihma ndaj njerëzve në nevojë. Kudo synon të jetë i pari e të ngrejë flamurin kombëtar shqiptar.

Kam kohë, që nëpërmjet disa videove, e shoh Gentianin në Kinë si pjesëmarrës dhe fitues në shumë gara me biçikletë ku valëvit flamurin tonë kombëtar, në ngjitje malore sportive e plot aktivitete të tjera. Pasioni i tij është të ecë me biçikletë, të vrapojë në distanca të gjata, duke dhënë mesazhin e vëllazërimit midis njerëzve dhe popujve dhe ndihmën ndaj njerëzve në nevojë, sidomos fëmijëve, në mënyrë të veçantë gjatë pandemisë COVID-19.

Gentiani ka shkuar vullnetarisht në Madagaskar, të Afrikës për të ndihmuar fëmijët më të varfër, duke u mundur të përcjellë një mesazh paqeje në Afrikë dhe Kinë gjatë kohës së vështirë të coronavirusit.

Para disa vitesh Gentiani së bashku me 5 kinezë ishte në Berat, Vlorë e Sarandë, pa anashkaluar edhe Kallarat vendlindjen e babait të tij, Memo Qejvanaj, njeriut të urtë e punëtor, për të promovuar turizmin dhe bukuritë natyrore të Shqipërisë.

Gentiani shquhet për aventurat e tij, por me një domethënie e mesazh të qartë të miqësorë njerëzit e popujt midis tyre, të promovojë vlerat dhe të ndihmojë njerëzit e varfër, veçanërisht fëmijët.

Aventura e re e Gentianit do të jetë maratona me biçikletë KINË - SHQPËRI, të cilën e deklaroi në takim dhe kërkon mbështetjen e të gjithëve.

Personalisht, por besoj se shpreh edhe mendimin e gjithë kallarataseve, le ta falënderojmë Gentin për pasionin që ka e ta mbështesim në punën e tij dhe gjithçka që bën nëpërmjet sportit duke njohur Shqipërinë në Kinë e largët dhe në vende të tjera e duke valëvitur flamurin kombëtar kuq e zi, për të cilën na bën krenar edhe ne si fshat. Atje në Kinë e largët, kur ngrihet flamuri ynë kombëtar, është një lloj sikur është ngritur flamuri i shoqatës që identifikon Kallarat.

Gentit, i urojmë suksese dhe e mbështesim në aventurën e re të tij vitin e ardhshëm me biçikletë Kinë - Shqipëri e ta përfundojë atë në Kallarat.

FJALË E MBAJTUR

PAS NJË VITI, 5 GUSHT 2024

PRITJA NË KALLARAT, ORGANIZUAR
NGA SHOQATA "KALLARATI"

Ashtu siç e kishte parashikuar vetë "aventurieri" Gentian Qejvanaj më 5 gusht 2024, ora 16:00 mbërriti në Kallarat, pasi një ditë më parë ai kishte kaluar pikën e kufirit në Qafë Botë, ku u prit nga vëllai i tij Fatjoni. Gentiani u ndie i lehtësuar e plot emocione që më në fund pas gjithë atij udhëtimit të gjatë midis dy kontinenteve dhe shumë shteteve, shkeli me biçikletë tokën shqiptare. Më tej ai vijoi udhëtimin drejt Kallaratit, ku në hyrje të Kallaratit, në kufirin me Kuçin kishin dalë familjarët, të afërm dhe bashkëfshatarë të tij.

Udhëtimi vijoi drejt qendrës së fshatit, në Morrez, aty në sheshin kryesor të Kallaratit aty ku një vit më parë dha fjalën për këtë udhëtim aventuresk, të cilën më në fund e bëri realitet.

Qendra e fshatit ishte zburuar me flamuj, parulla, ku binte në sy një banderolë e madhe me foton e tij dhe biçikletën. Për të pritur birin e tyre, edhe pse kohë e nxehtë e temperatura të larta, kishin dalë shumë bashkëfshatarë, banorë të Kallaratit, por edhe të ardhur nga fshatrat fqinje dhe qyteti i Vlorës.

Duartrokijte, brohoritje për Gentianin, takime të përzierme, përqaftime, lot e gëzim nga familjarët e tij.

Kryetari i shoqatës "Kallarati" z. Kastriot Karabollit, kryeredaktori i gazetës Kallarati z. Lefter Hysaj, etj i uruan Gentianit mirëseardhjen në Kallarat dhe e përgëzuan për mbajtjen e fjalës së dhënë një vit më parë për përshkrimin e rrugës së gjatë Kinë - Kallarat me biçikletë, si dhe për mesazhet e përcjella prej tij në mediat e ndryshme ku kryefjala ishte fjala "Kallarati".

Në fjalën e tij Gentiani falënderoi pjesëmarrësit, familjen, të afërmit, bashkëfshatarët, si dhe kryesinë e Shoqatës "Kallarati", për mbështetjen morale dhënë



"Premtimit i Gentianit një vitë në parë në takimin e brezave, 12 gusht 2023"

MË 12 GUSHT 2023

Gentian Qejvanaj duke marrë pjesë në "Takimin e Brezave" në Kallarat më 12 gusht 2023, deklaroi se në takimin e vitit tjetër 2024 do të realizojë aventurën më të gjatë të jetës time, atë ardhjes me biçikletë nga Kina në Kallarat.

Gentian Qejvanaj, i ndodhur prej disa ditësh në Kallarat (pasi prej 10 vitesh jeton në Kinë), ardhur me mjetin e tij të preferuar, biçikletën, mori pjesë për herë të parë në takimin e brezave në vendlindjen e babait të tij Memo Qejvanaj.

Personalisht nuk isha në dijeni se Genti ndodhej pikërisht në këtë takim. Po ta shihja, edhe pse nuk isha takuar me të asnjëherë, me siguri do ta njihja, pasi e kam ndjekur nëpërmjet videove të tij në Youtube, por duke qenë pjesëmarrje e madhe, si asnjëherë tjetër, jo me të gjithë arrita të përshëndeteshja e të takohesha. Duke qenë se isha duke ndjekur prezantimin e moderatores, në kohën që poetesha Lela Qejvanaj në fjalën e saj përshëndetëse përmendi faktin që në këtë takim brezash kanë ardhur shumë emigrantë nga

dhe ishte krijuar një pauzë, ku ishte mundësia më e mirë që Genti të bënte një prezantim e përshëndetje, e marrë Gentin për krahu dhe i afrohem Anilës e i them: "Genti është një djalë me origjinë nga Kallarati, sportist në Kinë dhe do të jap një mesazh pjesëmarrësve". Dakord - tha Anila - mikrofonit është për të. Kështu ndodh edhe në spektakle më të mëdha, kur del diçka jashtë skenarit, por që janë shumë herë më të bukura se ato të planifikuara.

Genti mori në dorë mikrofonin dhe në fjalën e tij, pasi u prezantua me një shqipe të kuptueshme, falënderoi organizatorët për këtë event shumë të bukur, përshëndeti të gjithë kallaratasit dhe në fund dha fjalën se, në takimin e vitit tjetër do vij në Kallarat me biçikletë nga Kina. Duartrokijte të mëdha nga pjesëmarrësit ushtuan sheshin.

Genti, megjithëse është diplomuar për Shkenca Politike në Itali, ka punuar në Parlamentin Evropian, ka kryer Doktoratë në Kinë për Çështjet Publike me një studim krahasues midis Shqipërisë dhe Kinës,





gjatë gjithë udhëtimit, si dhe pritjen mjaft të ngrohtë e mbresëlënëse organizuar në qendër të fshatit. Shpërblimi im ndaj jush - u shpreh Gentiani - do të jetë ndërmarrja e aventurave të tjera duke i rritur vlerat Kallaratit e Vlorës, në çdo vend të botës ku unë shkel.

Pas një qëndrimi të shkurtër në Kallarat Gentiani vijoi udhëtimin me biçikletë drejt Vlorës edhe 50 kilometrat e fundit, ku në orën 19:00, bashkia e Vlorës kishte organizuar një pritje zyrtare para Pallatit të Sportit Flamurtari “.

PRITJA NË VLORË, ORGANIZUAR NGA BASHKIA

Në mbrëmjen e datës 5 gushtit 2024, ora 19:00 çiklisti Gentian Qejvanaj mbërriti në Vlorë në qytetin e tij të lindjes.

Aventura e Gentianit, e nisur më 30 qershor nga Kina me biçikletë, e pasi kaloi në 7 shtete rreth 3600 km, përfundoi në Vlorë.

Në Vlorë, para Pallatit të Sportit “Flamurtari”, bashkia e Vlorës, sektori i sportit kishte përgatitur një pritje simbolike dhe shumë domethënëse. Në hyrje të Vlorës Gentiani u prit nga një grup çiklistësh të Vlorës, të cilët e shoqëruan atë drejt Pallatit të Sportit. Mbërritja e tij me biçikletë u prit me duartrokitje të forta nga pjesëmarrësit. Merrnin pjesë mjaft qytetarë të zakonshëm vlonjatë, njerëz të sportit, bashkëfshatarë kallaratas me banim në Vlorë, por edhe të ardhur enkas nga Kallarat, si dhe familjarë e të afërm të Gentianit.

Merrnin pjesë gjithashtu nënkryetari i bashkisë së Vlorës z. Klevis Taso, drejtoresha e sportit po të

bashkisë znj. Elona Merkaj, si dhe kryetari i shoqatës “Kallarati” z. Kastriot Karaboli.

Nënkryetari i bashkisë z. Klevis Taso pasi përshëndeti të pranishmit, i uroi Gentianit mirëseardhjen në qytetin e tij të lindjes, Vlorën, si dhe vlerësoi sakrificën e madhe bërë me biçikletë nga Kina në Shqipëri. Në fund në emër të kryetarit të bashkisë z. Ermal Dredha iu dorëzua “Certifikata e Mirënjohjes” si dhe flamuri i qytetit evropian të sportit për vitin 2024.



Vetë Gentiani, duke marrë certifikatën falënderoi pjesëmarrësit e qytetarët vlonjatë për mikpritjen, si dhe falënderoi bashkinë e Vlorës për pritjen dhe vlerësim e bërë.

“Faleminderit Vloraaa, kam 10 vjet që jetoj në Kinë dhe jam Shqiptar. Është një lidhje nga ana shpirtërore, tani më bën krenar dhe do jetë një kujtim, familjes time që në fillim nuk më besonin e pastaj filluan të kuptonin që nuk ishte vetëm për veten time, por edhe për të gjithë shqiptarët, Vlorë e vlonjatëve nuk është vetëm një vend për bregdet por edhe një vend për aventura si kjo”, - tha Gentian Qejvanaj.

Në fund të aktivitetit zonja Lela Qejvanaj në emër të familjes falënderoi pjesëmarrësit për pritjen e ngrohtë të realizuar

Pas përfundimit të aktivitetit u bënë voto dhe u shtrua një koktejl.

Duke i bërë disa pyetje të shpejta Gentiani do të përgjigjej:

A të shkoi ndonjëherë në mendje ta ndërprerje aventurën?

“Jo, asnjëherë nuk kam menduar të dorëzohem edhe pse kam marrë shpime në të dy rrotat e biçikletës disa herë, edhe pse më kapi një stuhi mbi 3500 metra mbi nivelin e detit, edhe pse temperaturat ishin të larta në disa zona. Fjalën e dhënë para Kallaratit, dëshiroja ta bëja realitet dhe më në fund e bëra.

Si u ndjeve kur hyrë në kufirin shqiptar?

Kalimi i kufirit shqiptar në Qafë Botë, ishte shumë domethënëse, sepse po hyja në atdheun tim për të cilin mora këtë aventurë, por pas kalimit të

kaq shumë kufijve ishte vetëm një më shumë, por ky ishte i fundit.

Po kur takove nënën tënde Zamirën?

Vëllai i madh Fatjoni, i cili jeton në Suedi kishte dalë në kufi, kurse mamaja Zamira më priste në Kallarat. U gëzova shumë kur pashë mamin, sepse ajo si gjithë nënat ishte në merak të madh dhe kishte një muaj që më ndiqte e nuk vinte gjumë në sy, aq më tepër që babai më është ndarë nga jeta vite më parë. Kështu që isha i lumtur që e pashë dhe nuk e ndanim njëri tjetrin nga përqaftimi me mall.

Si e konsideron pritjen në qendër të fshatit të Kallaratit dhe në Vlorë?

Mirëpritja si në Kallarat, ashtu edhe në Vlorë ishte e mahnitshme. U befasova vërtet kur pashë se kaq shumë njerëz ishin të lidhur dhe të interesuar për aventurën time në përputhje me rrethanat. Gjej rastin të falënderoj shoqatën “Kallarati” dhe bashkinë e Vlorës.

Aventurat tuaja të ardhshme, apo me kaq deri këtu?

Ndjej sikur kjo aventurë nuk po ndalon këtu, mund të ketë diçka që do të ndodhë vitin e ardhshëm ose ndoshta edhe më herët. Do t’ju mbaj të informuar dhe shpresoj shumë që mund ta bëj këtë aventurë herën tjetër me ndonjë shqiptar tjetër që mund të frymëzohet nga përvoja ime.

Mesazhi juaj për të rinjtë në aspektin e marrjes me sport?

Ushtroni çdo lloj sporti se është jetë, aq më tepër ecjet e gjata dhe me çiklizëm, por aventurat e mia nuk jua rekomandoj.

MBI EKZISTENCËN E VARREVE CMOKTHINJOTE NË “FSHATIN E DJEGUR”

Në lidhje me temën e hapur në portalin e fejsbukut të shqatës “Kallarati” mbi varrezat në “Fshatin e Djegur”, komentuesit e shumtë përmendën edhe faktin e ekzistencës së varreve smokthinjote .

Lidhur me këtë fakt, profesor Rami Memushaj na dërgon një shpjegim rreth tyre, si dhe disa dokumente (pjesë nga libri i Eqrem Bej Vlora) që vërtetojnë se i smokthinjoti Hysejn Memo Rojta (Rrozhdha) rreth viteve 1820 ka qenë strehuar në Kallarati, në atë kohë rrëzë Pilingrisë dhe është vrarë nga kundërshtarët e tij po smokthinjotë.

Këtë fakt e lidh edhe me një dorëshkrim (kumtesë) të mbajtur në Ramicë nga një smokthinjotë në vitin 1968.

Ja si shkruan profesori:

Hysejn Memua ishte komandant i gardës së Ali Pashë Tepelenës. Ky e dërgoi në Smokthinë për të vrarë Ibrahim Pashën, kundërshtar i tij, që ish strehuar te miqtë e tij, te fisi i dëgjuar Agaj. Pas disa ditë luftimesh, Ibrahim Pasha dorëzohet dhe bashkë me të shoqen edhe të birin, Hysejn Memua i dërgoi me urdhër të Ali Pashës në Konicë, ku u internuan, ndërsa Ymer Mustafa Agajn edhe Zoto Agajn i shpunë të lidhur në Ujë të Ftohtë, ku ushtria e Ali Pashës i vrau, ndërsa të afërmit i internoi.

Më tej, profesori shkruan se në kohën që Ali Pasha ishte mbyllur në Kalanë e Janinës, Hysejn Memo Rojta, u arratis me fëmijët e vet nga Janina dhe erdhi në Lumin e Vlorës për t'u fshehur më vonë në Myzeqe. U strehua në Kallarati, te një i Qejvanaj, me të cilin kish miqësi (te Toto Qejvani, apo te djemtë e tij, Alikua ose Novruzi). Nuk dihet me saktësi si e morën vesh smokthinjotët, u lajmëruan nga pleqësia e Kallarati (historikisht fshati ynë ka pasur lidhje të ngushta me Smokthinën)?

Eqrem Vlora thotë se i zunë pritë nën Bolenë, po kënga dhe vetë ramicjotët thonë ndryshe (lexoni skedën). Që janë vrarë në Kallarati, këtë e provon dhe ekzistenca e toponimit “Varret e smokthinjote”. (Për më tepër lexoni shkrimin e shkëputur nga libri i Eqrem Bej Vlora, faqe 377-380):

Në qershor të vitit 1810, Ibrahim Pash Vlorë Sanxhakbeu u detyrua t'i dorëzojë, mbas një rrethimi që vazhdoi disa muaj, kalanë e Beratit, Ali Pashë Tepelenës dhe të tërhiqet në Vlorë (në shtëpinë e të vëllait Xhafer Pashajt). Por Pashaj, sadoqë ish zyrtarisht ende Sanxhakbeu i Vlorës, nuk e ndjente më veten të sigurtë në Vlorë. Një pjesë e parisë së vëndit i ishte bërë armike. E akuzonin Pashan se më 1806 kishte hedhur në pusin e shtëpisë të lartpërmendur nipin e tij Sylejman Benë dhe më 1809 kishte dhënë urdhër



të mbysin të dy djemtë e tij të mitur. Ibrahim Pasha vendosi pra (në Gusht 1810) të shkojë në Dukat e në Himarë e që andej të hidhej në Korfuz për të kërkuar mënyrën se si të shkonte në Stamboll.

Mirëpo brenda pak ditëve u çfaq rreziku që rruga e shpëtimit mund të mbyllej. Anijet e luftës angleze, që shëtisnin midis Karaburunit edhe Himarës nuk mund ta lejonin një udhëtim të tillë të Ibrahim Pashës sepse qeveria angleze përkrahte në atë kohë Ali Pash Tepelenën në kundërshtim me politikën miqësore të Ibrahim Pash Vlorës për Francën.

I dëshpëruar nga këto rrethana, Ibrahim Pasha kërkoi strehë në Lumin e Vlorës, ku kishte mjaftë përkrahës. Vajti në Smokthinë (Ramicë) në shtëpinë e një besnikut tij, Ymer Mustafa Agajt. Ky ishte i pari i Smokthinës, ishte plaku i fisit trim të Agajve, dhe i nipi Zoto Agaj, i cili kishte ndërtuar në truallin e shtëpisë tyre një kullë madhështore, ku mund të pritej Pashaj me të shoqen (Ymni Rabia Hanën e njohur me emrin Hanko Pasha) edhe me djalin e tij. Në këtë kullë Agajt deshën ta vendosin Ibrahim Pashën, por i zoti i kullës, Zoto Agaj, i shtyrë dhe i bindur nga e shoqja, që e këshillonte të qëndronte pak i paanshëm në grindjen midis dy Pashallarëve. Kështu Pashaj u vendos në kullën e Ymer Mustafa Agajt, që ishte po në atë truall i rrethuar me mure të larta.

Ali Pasha kish porositur qysh me kohë parinë

e Vlorës të mos përkrahte Ibrahim Pashën, nëse donin që Vlorë të mbetej e pa prekur nga pasojat e luftës. Mirëpo, një pakicë e parisë nuk ja dëgjoji fjalën. Atëhere Pashaj i Janinës nisi për në Smokthinë një ushtri të mjaftueshme nën komandën e një besnikut të tij, Hysejn Memo Rojta. Ky ishte vet i cmokthinjotë dhe kishte qëndruar dhe luftuar bashkë me Ali Pashën në ditët e tij të mira e të këqija edhe ishte bërë një nga komandantët e Gardës së tij. Hysejn Memo kishte marrë urdhër ta zinte Ibrahim Pashën të gjallë edhe t'i jepte fund çdo kundërshtimit në Lumin e Vlorës. Në tetor të vitit 1810 mbërriti ushtria (1500 veta, si mbas gojëdhënës) dhe rrethoi menjëherë truallin e Agajve, kërkoi dorëzimin e Ibrahim Pashës edhe për ta trembur shtiu disa herë me dy topa të vegjël që kish prurë me vete. Ky bombardim i papritur nuk i trembi të rrethuarit, por i hapi sytë Zoto Agajt, i cili kuptoi, që qëndrimi i paanshëm nuk gjeti asnjë kuptim ndaj Hysejn Memo Rojtës.

Vazhduan luftimet rreth kullave të Agajve tri ditë. Njëzet e tre burra nga fisi i këtyre trimave u vranë bashkë me shumë burra të tjerë. Më së fundi vendosën të dorëzohen. Ibrahim Pashën, të shoqen edhe të birin, Hysejn Memo e dërgoj me urdhër të Ali Pashës në Konicë, ku u internuan. Ymer Mustafa Agajn edhe Zoto Agajn i shpunë të lidhur në Ujë të Ftohtë, ku ushtria e Ali Pashës kishte ngritur kampet e saj.


Të dy Agajt i vranë në vend dhe i varrosën mbi bregoren që përbënte pjesë kopshtit të pushimit të

ushtrisë së Ali Pashës, të tjerë të afërm të tyre u internuan.

Mirëpo ngjarjet e lartpërmendura patën edhe një pasojë që vlen të tregohet: Në prill të vitit 1820 djemtë dhe nipërit e Ymer Mustafajt edhe Zoto Agajt u kthyen në Vlorë, që me gra e me foshnja kishin qenë internuar nga Ali Pashë Tepelena në Kalanë e Prevezës. U kthyen me flotën turke që solli nga Stambolli Ismail Ben dhe Beqir Be Vlorën. Në këto rrethana edhe Hysejn Memo Rojtja, u arratis me fëmijët e vet nga Janina edhe erdhi në Lumin e Vlorës për t'u fshehur më vonë në Myzeqe. Ali Pasha në atë kohë ishte mbyllur në Kalanë e Janinës, sepse mbreti e kishte dënuar me vdekje. Hysejn Memo e la të zotin në baltë dhe kërkoi të shpëtojë kokën e vet. Karvani i tij për siguri ndoqi një rrugë të jashtëzakonshme. Erdhi në Delvinë edhe andej në Borsh e në Kallarati, ku kishte disa miq. Në katund (në atë kohë Kallarati ishte rrëzë Pilingrisë) qëndroi për të studiuar mënyrën më të sigurtë për të shkuar në Myzeqe.

Mirëpo ndërkohë Agajt e muarën vesh ardhjen e tij dhe i zunë një pritë, në katundin Bolenë, thuhet në këtë shkrim, por që nga këngët dhe ekzistenca e një varri të tillë edhe sot, duhet të ketë qenë në “Fshatin e Djegur” të sotëm. Në përpjekjen që u bë, u vranë gjithë pjesëtarët e familjes Rojta. Vetëm një grua shpëtoi, sepse ishte me barrë, e cila lindi djal, pasardhësit e të cilit mbajnë edhe sot mbiemrin Rojta. Në Smokthinë kishte mbetur nana plakë e Hysejn Memo Rojtës në kasollen e saj. Ajo nuk deshi kurrë, të ndjekë gjurmët e gjakut që lartësuan të birin. Djali edhe fare fisit i ngriti një vaje, që edhe sot këndohet në Labëri:

“...Vjen Hysejmi nga kurbeti,
(Kori)
Hysejn-o! bilbil-o! Qaj moj nën'e varfër'o!
Me mall shumë si gjysëm Mbreti/
Kallarati mirë e prinë/
Therë desh dhe e gostinë!
...Prit Hysejn se po harrinë/
Ata që s'pëlqeje tinë/ Smokthinjot gunëdhirë...
(Monologu i vajes)
Ju që patë këtë përpjek/
Qofshi ëngjëj ose dreq/
Thomi kujt kërkon ta di/
Që po qanë nën'e shkret,
Se Hysejmi s'vjen përsi...
Nga sa del edhe nga ky shkrim, nga vetë emri që u ka mbetur varreve në “Fshatin e Djegur”, që banorët e sotëm në Kallarati, nga çfarë kanë dëgjuar nga të parët e tyre i quajnë “Varret e cmokthinjote” ose “Varret e Ramicës”, ato varre duhet të ekzistojnë si të tilla.



HESHTJA E BABIT... (Dashuri dhe refleksion)



NGA BAJRAM KARABOLLI

E ke menduar ndonjëherë se si ndihet babai yt...?

Besoje apo jo, babai yt mban në mendjen e tij një mal me shqetësime, e megjithatë ecën përpara çdo ditë, pa treguar asnjë shenjë dobësie.

Nëse babai yt të thotë se është mirë, mos e gjyko dhe mos mendo se ai dëshiron të shmangë realitetin. Ai mban në zemër një peshë që nuk e shpreh dot, sepse duhet të jetë shtylla e fortë për familjen, të zgjidhë problemet dhe të shqetësohet për mirëqenien e të gjithëve, ndërsa nevojat e veta i harron.

Edhe babi lodhet...

Edhe ai ndihet i vetmuar...

Ai gjithashtu ka nevojë për një përqafim...dhe ti rrallë e pyet: Si je sot, baba?

Ai është mbrojtësi, ofruesi, këshilltari i hesh-tur, rregulluesi i gjithçkaje, ai që duhet të ketë gjithmonë përgjigjen...

Por gjëja më e rëndësishme është dhe do të jetë gjithmonë mbështetja jote...

Nëse ke probleme, ai do të të ndihmojë dhe do të të thotë se gjithçka do të jetë në rregull. Nëse paratë janë të pakta, ai do të gjejë një mënyrë për të mbuluar shpenzimet, por nuk do të të zhgënjë kurrë.



GURI ME HIJE

Guri me Hije, gjendet në Grykën e Honit në M. Bogonicës në lartësinë 900m. Duket rreth 15 km larg. Fshatarët e Kallaratit, Bolenës dhe Kuçit, mbështetur në vëzhgimet e shumta, në të kaluarën, hijen e tij e shfrytëzonin për të matur kohën gjatë ditës nëpërmjet lëvizjes së hijes së shkëmbit. Ndaj dhe populli këndon:

*"Dielli malit kur bie,
ndriçon tek Guri me "Hije",
guri që kohën tregon,
asnjë minut nuk gabon"...*



KARTOLINA E VITIT TË RI 2025

Njoftimit dhe kërkesës tonë për dizajnimin e një kartoline iu përgjigjën pak veta dhe nga krijimet e paraqitura, të cilët i falënderojmë, zgjodhëm si punimin më të arritur artistikisht dhe në përmbajtje, kartolinën e punuar nga Vanesa Shtaj nga Vranishti dhe mbesë e Luto Demirit në Kallarat, vajza e Eglantina Shtaj (Demiraj), nxënëse e klasës së 8 -të në shkollën 9 - vjeçare "24 Maj", Vlorë.

Kryesia e shoqatës e falënderon nga zemra për përfshirjen e saj në këtë nismë sa artistike aq edhe festive.

Kartolina e realizuar nga Vanesa, është një përmbledhje simbolike që reflekton bukurinë e traditës, historisë dhe identitetit të fshatit Kallarat, si pjesë e trevës së Labërisë. Përfshirja e Vanesës në këtë krijim tregon dhe shpreh dashurinë e saj për gjyshin, gjyshen dhe vendlindjen e mamasë së saj Kallaratit.

Elementet kryesore që përfshijnë kartolinën:

1. Natyra

Në qendër qëndron një pamje e mrekullueshme e malit të Bogonicës, veshur me vellon e bardhë, që tregon stinën e dimrit dhe që simbolizon krenarinë dhe qëndresën e kallarasve ndër shekuj. Ky mal është pjesë e identitetit gjeografik dhe shpirtëror të fshatit tonë.

2. Urimi

"Gëzuar Kallarati!" Shkruar me një dizajn të bukur artistik, ky urim pasqyron shpirtin e bashkimit dhe gëzimit për ardhjen e Vitit të Ri.

3.Simbolet Kombëtare

Flamuri shqiptar: Paraqitur në formë dekorative, flamuri me shqiponjën dykrenare i jep kartolinës një dimension patriotik.

Qeleshja: Qeleshja e bardhë përfaqëson traditën dhe kulturën e Labërisë dhe më gjerë të shqiptarëve. Qeleshja në Labëri është një nga pjesët më të njohura të veshjes tradicionale të burrave shqiptarë dhe ka një rëndësi të veçantë historike dhe kulturore. Qeleshja nuk është thjesht një mbulesë koke; ajo është një simbol i traditës,



Punuar nga Vanesa Shtaj

nderit dhe identitetit lab që vazhdon të ruhet dhe të trashëgohet nga brezi në brez.

Qeleshja dhe sharku: Personazhi në të majtë është veshur me kostum tradicional, ku bie në sy qeleshja dhe sharku, veshje simbol e çobanëve dhe burrave të Kallaratit e të mbarë Labërisë që

i ka mbrojtur nga të ftohtit dhe shiu. Sharku i çobanit në Labëri është një veshje tradicionale dhe funksionale, e cila përbën një simbol të jetës së vështirë dhe të lidhur ngushtë me natyrën e çobanëve. Sharku është i njohur për rolin e tij praktik, por edhe për vlerën kulturore dhe simbolike që

mbart. Qeleshja në kombinim me elemente të tjera si sharku, fustanella dhe këngët labe, formojnë një pjesë të rëndësishme të kulturës dhe historisë së Labërisë.

4. Instrumenti muzikor

Longari: Instrumenti muzikor i paraqitur në të djathtë është një simbol i muzikës tradicionale shqiptare të Labërisë. Longari ose cylja dyjare është më shumë se një instrument muzikor. Ai është pjesë e identitetit kulturor të Labërisë, duke shoqëruar këngët, historitë dhe traditat që e bëjnë këtë krahinë unike në trashëgiminë muzikore shqiptare. Tingujt e tij të veçantë vazhdojnë të mbushin me emocione festat dhe ngjarjet e rëndësishme, duke lidhur të kaluarën me të tashmen. Ky instrument shpesh lidhet me jetën e çobanëve në vetmi dhe muzikën që ata krijojnë në male gjatë kullotjes së bagëtive.

5. Atmosfera festive

Kartolina është e mbushur me fishekzjarrë dhe elementë të artë, që pasqyrojnë gëzimin dhe festimin e Vitit të Ri 2025.

Si përfundim mund të themi se Vanesa ka përmbledhur e kombinuar me mjeshtëri, artin, traditën dhe ndjenjën patriotike të kallarasve, duke krijuar një kartolinë të bukur që përfaqëson, jo vetëm një urim, por edhe krenarinë për origjinën dhe historinë e origjinës së saj Kallaratit. Ky krijim përbën një shembull të shkëlqyer për brezat e rinj që mbajnë gjallë trashëgiminë kulturore dhe historike.

Me këtë rast Vanesa shpallet fituese e këtij konkursi në prag të festës së Vitit të Ri 2025. Kjo kartolinë do të jetë kartolina me të cilën natën e Vitit të Ri, kryesia e shoqatës do të urojë gjithë kallarasit kudo që ndodhen, miqtë dhe shokët dhe gjithë dashamirësit e Kallaratit.

Kryesia e shoqatës "Kallarati" i uron Vanesës dhe me këtë rast gjithë fëmijëve kallaras e jo vetëm, "Suksese në rrugën e dijes e të ruajtjes së traditave të trevës së Labërisë dhe asaj shqiptare"

KUJTESË E NOSTALGJI PËR ÇERDHEN DHE KOPSHTIN E FËMIJËVE NË KALLARAT

Ndoshta jo të gjithë kallaratasit, sidomos ata të moshës së tretë, e kanë pasur mundësinë të kalonin fëmijërinë e tyre në çerdhe e kopsht, pasi ato janë hapur më vonë.

Para viteve '90, ashtu si gjithë fshatrat e Shqipërisë edhe Kallarati kishte çerdhe dhe kopsht që ofronin një kujdes të veçantë për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Strukturat shtetërore të asaj kohe vlerësonin domosdoshmërinë e hapjes dhe funksionimit të çerdes e kopshtit për fëmijët nga një vjeç e deri në klasën e parë, rritjes së shëndetshme të tyre e marrjen e elementëve të parë të sjelljes, edukatës e dijeve për në shkollë nëpërmjet edukatorëve të papërtuara, duke ndihmuar e krijuar mundësinë në integrimin të nënave në punë, sidomos në kooperativën bujqësore.

Edukatorët ishin figura të shquara, gra e vajza tepër të kujdesshme, një pjesë e mirë e të cilave, sidomos edukatorët e kopshtit kishin përfunduar edhe arsimin e mesëm pedagogjik. Ato ofronin një mjedis të sigurt dhe edukativ për fëmijët, ku ata merrnin njohuritë fillestare që do t'i shoqëronin në jetë.

Nënat, që herët në mëngjes linin fëmijët e tyre te edukatorët, ndonjëherë edhe me temperaturë, duke pasur besim të plotë në përkushtimin e tyre dhe vraponin për në punë.

Edukata familjare e gërshetuar me edukatën e ofruar në çerdhe dhe kopsht luante një rol kyç në formimin e personalitetit të fëmijëve. Ky kombinim ndihmonte në zhvillimin e aftësive sociale, emocionale dhe intelektuale, duke i përgatitur ata për shkollim të mëtejshëm dhe për jetën e përditshme. Njohuritë dhe vlerat e fituara që në moshë të vogël krijonin një bazë të fortë për të përballuar sfidat e jetës dhe për të ndërthur marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët. Prandaj, kujdesi dhe përkushtimi i edukatorëve ishin thelbësorë për suksesin e fëmijëve në të ardhmen e tyre.

Godina e kopshtit dhe çerdes në Kallarati që shikoni në këtë foto, e ndërthuar në vitet '80, ka shërbyer si një qendër e rëndësishme për edukimin dhe rritjen e breza të tërë fëmijësh.

Sot, mungesa e çerdes dhe kopshtit në Kallarati, kjo edhe për faktin e një numri shumë të vogël fëmijësh, është një humbje e madhe për komunitetin. Nënat shpesh detyrohen t'i mbajnë fëmijët në shtëpi ose t'i çojnë në kopshtin e Vranishtit, duke krijuar vështirësi për to në balancimin e punës dhe kujdesit për fëmijët. Kjo situatë thekson nevojën për rinovim të strukturave edukative për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve, por



edhe të integritit të nënave në punë private apo edhe shtetërore.

Roli i çerdes dhe kopshtit, jo vetëm në Kallarati, por kudo, mbetet një nevojë për nënat dhe të ardhmen e fëmijëve.

Kujdesi dhe sakrifica e edukatorëve të Kallaratis ndërr vite janë të paharruara, dhe sot ne i kujtojmë me shumë respekt e mirënjohje për kontributin e tyre në zhvillimin e brezave të rinj.

Një pjesë e suksesit që fëmijët e dikurshëm të Kallaratis janë bërë dikush në jetë, është meritë edhe e këtyre edukatorëve të përkushtuara.

Të gjithë ata që kanë mbresa dhe kujtime nga vetë koha e të qënurit në çerdhe e kopsht, apo të fëmijëve të tyre, si dhe vlerësime të veçanta për edukatorët, janë të lutur të ndajnë përvojat e tyre. Këto kujtime do të ndihmojnë në ruajtjen e historisë së komunitetit dhe do t'i japin një hapësirë nderimi për përkushtimin e edukatorëve që formuan brezat e rinj.



GRATË E KALLARATIT NË VIZITA KULTURORE E TURISTIKE

Gratë e vajzat e Kallaratis, të të gjitha moshave, gjithmonë bashkë në festa e gëzime në Kallarati, por edhe në aktivitete kulturore e turistike në vende historike, turistike e fetare kudo në Shqipëri.

Për këtë flasin edhe këto foto. Urime e suksese! Qofshin të bashkuara në çdo aktivitet!



ERMIRA KOLA (STRATI) ME KËNGËN E SAJ MË TË RE "KTHEHUNI"

Ermira Kola (Strati), një këngëtare e dashur e muzikës popullore, mjaft e njohur dhe e preferuar edhe në Kallarati, pas këngës të para disa muajve "Baba me vajza", që u mirëprit shumë nga publiku shqiptar, ka publikuar këngën e saj të fundit, të titulluar "Kthehuni". Nëpërmjet kësaj kënge, Ermira shpreh një mesazh të ngrohtë dhe të singertë për të rinjtë, që ndodhen jashtë vendit, të mos harrojnë vendlindjen, të kthehen te prindërit, babai e nëna që i presin me fjalë të ëmbla dhe dashuri.

"Kthehuni se ju pret nëna/

Do t'ju thotë ca fjalë të ëmbla"...

T'ju puth ball e duar/

O bijo, o biro

Qofshi të gëzuar/

O bijo, o biro"...



Kryesia e shoqatës "Kallarati" i uron Ermirës suksese të mëtejshme në rrugën e bukur të artit e muzikës.

TË PËRKRAHIM NISMËN PËR EVIDENTIMIN E FAMILJEVE KALLARATASE NË PERIUDHA TË NDRYSHME

KUJTIM SHABAN DAUTAJ (HYSAJ), lindur në Kallarat në vitin 1945 e banues në Fier na shkruan:

Të dashur bashkëfshatarë, kudo që jetoni! Ju uroj të gjitha të mirat, juve dhe familjeve tuaja. Në fejsbukun e shoqatës Kallarat shkruejnë e komentojnë shumë bij e bija nga Kallarat ose me origjinë nga Kallarat, që më lenë një ndjesi të mirë, por, shumë herë kërkoj t'i njoh. Më ka lindur një ide, që nuk e di në është e mundur të realizohet. Regjistrimi i popullsisë së Kallaratis është bërë në vitin 1945, por vetëm për familjet, që në atë kohë jetonin në fshat. Sikur të provonim të bënim një regjistrim të të gjitha familjeve kallaratase, kudo ku jetojnë, besoj, se do të ishte një veprim i mirë.

Me shumë dashuri e respect.



AGIM MATAJ nga Italia në lidhje me këtë nismë na shkruan:

Te nderuar bashkëfshatarë!

Duke u frymëzuar nga një propozim i Kujtim Hysit (Dautaj) për të pasuruar historinë e fshatit tonë duhet të fillojmë nga degët që jemi ne dhe të arrijmë te trungu ku secili nga ne duhet të japë kontributin e tij për aq sa di e për aq sa kujton, sepse brezi im është pothuajse brezi i fundit që mund të lërë gjurmë për historinë dhe vlerat që ka pasur e ka fshati ynë.

Unë për aq sa di e kujtoj kam shkruar historinë e fisit tim deri në 7 breza mbrapa. Kam tentuar të bëj edhe pak histori (për aq sa di që nga koha kur fshati ynë ishte në Kunjovë) nuk mund të jetë qind për qind e saktë, kjo mbetet për t'u verifikuar e për t'u pasuruar nga ata që dinë më shumë, por e vetmja gjë është që ata që dinë t'ju a lenë më të rinjve, qoftë në formë tregimi e historie apo gojëdhënë, asnjëherë nuk bën keq dhe kur ka mangësi, keq bën kur nuk tregohet e trashëgohet. Së shpejti do shkruaj aq sa di për historinë e fshatit e krahinës, ku ka vend për të ndërhyrë, korrigjuar e pasuruar, pastaj për mëhallët e fshatit, ku mund të ketë vend për ndonjë ndërhyrje dhe pastaj do shkruaj për fisin tim për shtatë breza dhe këtu nuk ka vend për ndërhyrje. Do doja që të gjithë bashkëfshatarët e mi të bënin të njëjtën gjë për fisin e tyre dhe kështu kemi një mundësi që me redaktorë të formuar të shkruajmë, jo historinë e fshatit tonë, por një enciklopedi të vërtetë dhe kështu nuk do u jemi borxhlinj brezave që vijnë. Na kanë ikur nga jeta shumë bashkëfshatarë që dinin shumë, por fatkeqësisht nuk u shfrytëzuan. Le të vëmë secili nga në një gur në këtë këshillë që është historia e fshatit tonë. Shpresoj të më mirëkuptoni dhe mundohuni të jepni kontributin tuaj.

Respekt për të gjithë.



Falënderojmë Kujtimin për idenë. Çdo nismë e marrë që u përket të gjithëve është e mirëpritur. Ato që nuk kemi pasur mundësi për t'ua marrë të parëve tanë për shkak të mungesës së teknologjisë dhe mos interesimit aq sa duhet, (individë të veçantë kanë bërë shumë në këtë drejtim, mbi bazën e të cilave janë botuar libra dhe vidoje, siç është edhe puna për historikun e fshatit), le të mos ta humbasim në këtë kohë, ku të gjitha mundësitë janë. Akoma kemi të moshuar në Kallarat e në qytete të tjera që dinë shumë gjëra për të kaluarën, dëgjuar e trashëguar me dokumente me shkrim nga prindërit e tyre, le t'i shfrytëzojmë për të marrë sa më shumë të dhëna, sa më shumë informacion, intervista, sa më shumë foto prej tyre, se brezat zëvendësojnë njëri - tjetrin, por Kallarat do të ngel aty dhe të gjithë do të kemi nevojë për të. Mbi të gjitha kemi plot intelektual të fushave të ndryshme që kanë dhënë kontribut të çmuar për fshatin dhe patjetër do të japin edhe në këtë drejtim kontributin e tyre.

Lidhur me këtë nismë, Kryesia e Shoqatës do të mblidhet dhe do të japë edhe orientime se si mund t'i grupojmë të dhënat, në çfarë formati, duke krijuar një databazë. Paraprakisht mendojmë që të dhënat të jenë:

- Emrat e kryefamiljarëve deri në vitin 1945 në Kallarat dhe në qytete të tjera me degëzimet e mbiemrit.
- Emrat e kryefamiljarëve pas vitit 1945 - 1990 në Kallarat dhe në qytete të tjera me degëzimet e mbiemrit.
- Emrat e kryefamiljarëve pas vitit 1990 e deri 2024 në Kallarat, në qytetet brenda Shqipërisë dhe jashtë vendit me degëzimet e mbiemrit.

Përsa më sipër mund të jepen ide të ndryshme, dikush mund ta marrë përsipër për të krijuar një aplikacion të veçantë, pasi është koha dixhitalizimit.

*Le t'i japim rrugë nismës së mësues Kujtimit.
Ju mirëpresim!*

VULLNET SINAJ, DEPUTETI I HALLEVE TË POPULLIT



është deputeti i dytë që ngjitet në malin e Bogonicës, pas deputetes kallaratase Nënë Duzes në vitin 1960 dhe shikon nga afër punën plot sakrificave të blegtorëve të zonës, aq më tepër të kësaj gruaje të vuajtur 75 vjeçare, por e përkushtuar në ushtrimin e këtij profesioni, që sot janë të rrallë që e frekuentojnë, sidomos brezi i ri. Përgëzime deputeti i halleve të popullit, i kudondodhur, jo vetëm në

qytet, por edhe në fshat, jo vetëm në fushë, por edhe në majë të malit, si rasti në fjalë.

Ja si shprehet deputeti Vullnet Sinaj rreth vizitës në stanin e Nënë Dylberes në Gjothanas: 'Nënë Dylberen së bashku me bashkëshortin Namaz Tozaj i takova në Vranisht në ditën e

votimeve për Bashkinë Himarë. I përgëzoja dhe e falënderova Nënë Dylberen që me gjithë 75 vitet që mban mbi supe, zbriti malin dhe kreu një detyrë të lartë qytetare duke dhënë kontributin e saj, në zgjedhjen e duhur për Bashkinë e Himarës. Më tregoi që jetonte dhe punonte vetëm në stan, pasi bashkëshortin e ka të sëmurë.

E pyeta se si ia bënte që, e vetme, të fuste delet për mjelje në shtrungë dhe ajo m'u përgjigj se e ndihmonte mushka. Me shaka, shtoi se edhe fëmijët e saj nuk e besonin. U habita shumë dhe i premtova nënë Dylberes se do të ngjisja unë malin dhe do ta takoja në stan. Ndaj, ajo u përlet kur e vizitova aty në Gjothanas, nën majën e Zogut. Së bashku me bashkëshortin time, vajzën e nënë Dylberes dhe bashkëshortin e saj si edhe me Sokol Gërdhuqin nga Piluri, i cili na udhëhoqi rrugën, u ngjitëm për 4 orë vargmaleve të bregut. E përqafova Nënë Dylberen dhe e falënderova për respektin dhe dashamirësinë. I urova shëndet dhe mbarësi dhe e vlerësova si një shembull të gjallë të punës së ndershme dhe qytetares së përgjegjshme!

Nënë Dylberja dhe të tjera si ajo, janë heroinat e vërteta të kohëve tona - përfundon Vullneti shkrimin e tij në fejsbuk.



Vullnet Sinaj, deputeti që di të vlerësojë njerëzit e punës e të sakrificave dhe mban fjalën e dhënë. Një vizitë në stanin e nënë Dylberes, në Gjothanas, më 10 gusht 2024, vlen më shumë se çdo fjalim nga foltorja e Parlamentit.

Siç - na tregon bashkëshorti i Dylberes, Namaz Tozaj (aktualisht invalid) - Vullneti



Fatos Ribaj është një artist me origjinë nga Kallarati, i lindur në Vlorë më 25 shkurt 1969. Aktualisht jeton në Itali, ku ka kaluar një pjesë të madhe të karrierës së tij artistike. Ribaj njihet për veprat e tij që ndërthurin elemente të realizmit dhe abstraksionit, duke krijuar një gjuhë vizuale unike dhe magjepsëse.

Veprat e tij janë të frymëzuara nga vendlindja e tij dhe pasqyrojnë një lidhje të thellë me rrënjët e tij kulturore dhe personale. Ribaj përdor një sërë teknikash dhe materialesh për të eksploruar tema si: identiteti, kujtesa dhe natyra. Kanavacat e tij karakterizohen nga ngjyra të ndezura dhe kompozime dinamike që tërheqin vëmendjen e shikuesit dhe e ftojnë atë të reflektojë.

Fatos Ribaj ka marrë pjesë në ekspozita të shumta në Itali dhe jashtë saj, duke u vlerësuar si një nga artistët më premtues në skenën bashkëkohore. Pasioni i tij për artin dhe përkushtimi ndaj punës së tij janë të dukshme në çdo vepër që ai krijon, duke i bërë veprat e tij jo vetëm tërheqëse vizualisht, por edhe thellësisht kuptimplote.

FATOS RIBAJ

MJESHTËR I ARTIT BASHKËKOHOR

*(Shkrim i botuar
në italisht)*



STEMA E SHOQATËS “KALLARATI”

Katër vjet më pare, tetor 2020 u bë rinovimi i stemës së shoqatës “Kallarati”, mbi bazën e stemës së mëparshme, realizuar në vitin 2003 me krijimin e shoqatës. Ideja: Besnik Gjonbrataj; kompozimi: piktori Fatos Ribaj; grafika: Klajdi Ribaj (djali i Fatosit).

ÇFARË PARAQET NË VETËVETE STEMEN

Në radhë të parë stema me elementët e saj, përshkruan pak a shumë historinë e fshatit në vite, shprehur grafikisht e në mënyrë artistike. Stema është konceptuar me dy rrahë koncentrikë me vijë të zezë dhe fushë të kuqe, që simbolizon flamurin kuq e zi, në të cilën me shkronja të mëdha e të dukshme është shkruar “SHOQATA KULTURORE DHE ATDHETARE KALLARATI”.

Fusha brenda stemës ka: Në qendër, malin e Bogonicës, simbol i qendrës së Kallaratit në shekuj.

Lart kryqëzim shpatash, marrë nga pllaka përkujtimore, bërë nga gurgdhendësi kallaratas Agim Mataj, sipas motiveve të vargjeve “Kallarat, Kuç e Bolenë, në lum e zunë dyfeknë”, realizuar në Koprifit, Kallarat, që simbolizon atë që Kallarati së bashku edhe me fqinjët asnjëherë nuk u është nënshtruar pushtuesve, përfshi edhe atë ndaj reformave të Tanzimatit.

Poshtë është lapidari kushtuar dëshmorëve të Kallaratit, që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e Kallaratit dhe për çlirimin e vendit në periudha të ndryshme të historisë.

Në qendër të fushës qëndron data e krijimit të shoqatës dhe motoja e saj si një thirrje bashkimi për të gjithë “Ec ngado, por Kallaratit mos e harro”.



DEDIKIM I FAMILJES SHAMETAJ PËR 86 - VJETORIN E LINDJES SË GAFUR SHAMETAJ (NDARË NGA JETA)

Në këtë 86 - vjetor të lindjes së Gafur Shametaj (ndarë nga jeta), familja e tij kujton me mall e dashuri njeriun e tyre të dashur, bashkëshortin, babain, që ishte shembull frymëzimi dhe përkushtimi për ta.

Gafuri, i ndarë nga jeta në vitin 2014, mbetet në zemrat e të gjithëve si një intelektual i shquar, një skenarist i artit dhe humorit vlonjat, një ish deputet i denjë i Vlorës në fillimet e demokracisë dhe një personalitet që dha kontribut të pazëvendësueshëm për Vlorën vendlindjen e tij, Kallaratën dhe mbarë shoqërinë shqiptare.

Si një nga nismëtarët e shoqatës "Kallarati", kryetar për disa vite dhe kryeredaktor i gazetës së saj, Gafuri punoi pa u lodhur për të mbajtur gjallë frymën patriotike dhe kulturore të Kallaratit, duke lënë pas një trashëgimi të vyer. Me këtë dedikim të ndjerë të familjes Shametaj, bashkohet edhe kryesia e shoqatës "Kallarati", duke shprehur mirënjohje të thellë dhe vlerësim për figurën dhe kontributin e tij të vyer intelektual, shoqëror dhe patriotik.

Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!



DEDIKIM I FËMIJËVE ME RASTIN E 14 VJETORIT TË NDARJES NGA JETA TË GJOLEKË MEMUSHAJ

I shtrenjti babi ynë! Sa shpejtë ikën vitet dhe vjen përsëri 9 gushti, një ditë e trishtë për ne fëmijët e tu. Sa shumë na mungon! Sa mallë ndiejmë! Sa dëshirë kemi të të thoshim përsëri në mëngjes "Ba mirëmëngjesi, si je? Të të takonim nga afër, të flisnim, të bisedonim, ashtu si dije vetëm ti, me atë fjalën tënde të ëmbël e plotë vlerë. Sa ëndrra kishe ti o babi, po jeta është gjithë të pa pritura, ku ne fëmijët e tu së bashku me mamën nuk po e besojmë dot, që ti nuk jeton! Na duket si kur një ditë do vishë përsëri. Të kemi dashur dhe të duam shumë i shtrenjti ynë! Jemi shumë krenarë që jemi fëmijët e tu! I pa harruar kujtimi në jetë të jetëve! Me shumë mall, respekt e mirënjohje, ne fëmijët e tu!

Edhe kryesia e shoqatës "Kallarati" i bashkohet kujtimit, që fëmijët bëjnë për babain e tyre Gjolekë Memushaj dhe shprehim vlerësim e mirënjohje për kontributin e tij në detyrat e kryera dhe aktivitetin shoqëror ndaj vendlindjes!



NËNË ILMUA, NËNA SHEKULLORE" ILMO MAÇI (1888 - 1987)

NGA BESNIK GJONBRATAJ

Nënë Ilmu, e njohur ndryshe si "Nëna shekullore," ishte një grua e veçantë, bijë nga fisi Xhaferaj i Kuçit dhe e martuar në Kallarat në fisin Maçaj të njohur për kontributet në mbrojtje të fshatit më 1914 ndaj andartëve grekë, pikërisht me Zenel Maçajn. Familja Maçaj ishte një familje e thjeshtë patriotike që merrej kryesisht me punët në bujqësi e blegtori. Në vitin 1921 familjes i erdhi në jetë djali i tyre i vetëm, Arshi Maçaj, i cili u rrit me ndjenjën e punës dhe të dashurisë për atdheun, ashtu si edhe paraardhësit e tij. Në kohën e pushtimit fashist e nazist të vendit, Arshi duke qenë në një moshë rinore, ashtu si edhe shumë të rinj kallaratas dhe të zonës së Labërisë, nuk ishte i orientuar drejt me qëllimin e pushtimit të vendit dhe fillimisht nuk zgjodhi rrugën e shumicës së burrave e djemve kallaratas, por më vonë e kuptoi dhe u inkuadrua shpejt në përbërje të Brigadës së 23 Sulmuese dhe mori pjesë në luftimet për çlirim e Shkodrës dhe deri në ish Jugosllavi. Por një sëmundje e rëndë u shfaq në atë kohë, "Tifua e morrit", që preku shumë partizanë, midis tyre edhe Arshin, i cili nuk i shpëtoi dot vdekjes. Në pamundësi shërimi, ai mbylli sytë më 15 janar 1945 atje në tokën jugosllave, duke lënë në pikëllim e dëshpërim të madh prindërit e moshuar, xha Zenelin dhe nënë Ilmon, të cilët nuk i mësuat dot kurrë, as varrin, djalit të tyre të vetëm.

Për shkak të kriterëve të asaj kohe, nuk iu njoh statusi "Dëshmor i Atdheut", duke e konsideruar "viktimit të luftës", çka e rëndoi akoma më shumë zemrën e nënë Ilmos, e cila nuk pati asnjëherë një varrë për të, ku t'a qante si çdo nënë djalin e vet.

E helmuar pas humbjes së të birit dhe më vonë rreth vitit 1956 edhe të bashkëshortit, Zenelit, nënë Ilmu jetoi e vetme mes pikëllimit e vështirësive të mëdha të kohës, atje në breg të Rapetës, ku edhe sot quhet "Bregu i Maçes", por gjithmonë me dinjitet dhe forcë shpirtërore, si një nënë labe e vërtetë.

Ajo, edhe pse me plot halle, jo vetëm të humbjes së njerëzve të saj, por edhe të shëndetit për shkak të moshës, ishte tepër humane. Kështu pas ndarjes së bashkëshortit, ajo për disa vite strehoi në shtëpinë e saj familjarisht Tahir Kondin, i ardhur nga Kurpica, që në atë kohë kishte nevojë urgjente për strehim. Aty nga viti 1968 Tahir ndërtoi shtëpinë e tij në Morrez dhe nënë Ilmu mbeti përsëri e vetme. E mbetur në këto kushte, e vetme dhe pa përkrahje të afërt, ku moshë bënte të vetën, nënë Ilmu gjeti mbështetje të



Sinan Hitaj një burrë plak që gjithashtu jetonte i vetëm. Ata vendosën të bashkëjetonin, por jo si bashkëjetesa e sotme e të rinjve, por për të ndarë të mirat dhe të këqijat e jetës, duke përbulluar së bashku vështirësitë e moshës. Ky bashkëjetim në një shtëpi, për disa vite, u bë një shembull i humanizmit mes dy shpirttrave të vetmuar që gjetën ngushëllim dhe mbështetje tek njëri-tjetri. Atje majë kodrës, në "Grykë të Hite", të cilën do t'a zbriste e ngjiste sa herë për të mbushur ujë në Qafë të Rrepeve, për të marrë bukën në furrën e fshatit e shërbime të tjera, apo edhe për vizita në familjet kallaratas, do të jetonte rreth 20 vjet me radhë nënë Ilmu, kjo nënë e veçantë, e fortë dhe një trimëreshë e vërtetë. Ajo u nda nga kjo jetë në vitin 1987, në moshën 99 vjeçare, pak pa mbushur shekullin, nën kujdesin e Sinan Hitit, e rrethuar nga respekti dhe përkrahja e bashkëfshatarëve të saj, të cilët e vlerësonin për mirësinë dhe zemrën e saj të madhe. Nënë Ilmu kishte një dashuri të pafund për çdo kallaratas, një dashuri që e ndante pa kursim edhe në periudhat më të vështira të jetës, duke dhuruar ç'të

kishte e duke përkrahur të gjithë.

Nënë Ilmu ishte grua e fortë, e duruar dhe fjalëpak. Shpesh rrinte në heshtje, por fjalët e pakta që thoshte ishin plot mençuri dhe dashuri. Ndonëse e varfër, ajo kishte zemrën e hapur dhe një shpirt të pasur, që reflektonte dhembshuri dhe kujdes për të tjerët. EDHE KUR KISHTE PAK, AJO DHURONTE SHUMË ME GJITHË ZEMËR. Një grusht sheqer, një palafike, një vesh rrush, një kokërr kumbulle e fiku, a një vezë të zier, dhënë me dashuri e bujari prej dorës së saj, kishte vlerën e mijëra të mirave materiale, që mund të të dhuronin të tjerët.

Të tillë e mbaj mend unë nënë Ilmon, të cilën e kishim gjithë dhe vinte shpesh te gjyshja ime, nënë Hatixheja me të cilën tregonin e qanin hallet e dertit e jetës, por ne si fëmijë shkonim më shpesh te shtëpia e saj në Grykë të Hite, qoftë edhe me bagëti. Ndoshta në atë kohë isha i vogël dhe nuk mund të kuptoja e përfytyroja dot se çfarë mbanin përbrenda rrudhat e saj në fytyrë, por sot duke kujtuar gjithë ato vuajtje të saj shpirtërore e ekonomike, me plot gojën them se

ajo ishte një "Nënë Heroinë". Nënë Ilmu u nda nga kjo jetë, duke lënë pas uratën e saj për kallaratasit, një trashëgimi shpirtërore që do të mbetet gjithmonë në zemrat e tyre. Kujtimi i saj, si një nënë e vuajtur e dhembshur, është një homazh për të gjitha nënat kallaratas që janë larguar nga kjo jetë, por kanë lënë pas dashurinë e pakushtëzuar dhe përkushtimin e tyre të pashtershëm. Ato janë shembulli i fortë i shpirtit të pastër e të patundur të nënave, që mbartën mbi vete dashurinë për familjen, njerëzit dhe vendin. Sot, nënë Ilmu, nuk ka asnjë pasardhës të afërt, por vlerësimi dhe mirënjohja për të mbeten të gjalla ndër breza. Për kallaratasit që e njohën, nënë Ilmu është më shumë sesa një kujtim i së shkuarës, ajo është simboli i dashurisë, humanizmit dhe sakrificës. Ndërsa kujtoj sot portretin e figurën e saj të një "Nëna labe", në mendje më vënë si zë i tanishëm fjalët e saj të dashura: "Të keqen nëna, të marsha," një shprehje dashurie që dëshmonte shpirtin e saj të pakufishëm prej nëne e gruaje të vuajtur, por tepër dinjitoze.

Qoftë i paharruar kujtimi i kësaj nëne kallaratase!

KUJTOJMË INTELEKTUALIN KALLARATAS PETRIT QEJVANI ME RASTIN E 10 – VJETORIT TË NDARJES NGA JETA

Kryesia e shoqatës “Kallarati”, në këtë dhjetëvjetor të ndarjes nga jeta të sekretarit të shoqatës, Petrit Qejvani, kujton me respekt e mirënjohje, intelektualin e mirëfilltë, njeriun e letrave, mësuesin e pedagogun e shkëlqyer, drejtuesin korrekt të institucioneve arsimore e të kulturës në qytetin e Vlorës, poetin, shkrimtarin, publicistin, kritikun letrar, analistin e shkëlqyer, që veç të tjerash i shkroi me aq nota pozitive vendit të origjinës, Kallaratin.

Petriti do kujtohet për herë nëpërmjet asaj çfarë ai la trashëgim si intelektual në librat e botuar, poezitë, tregimet, analizat politike e shoqërore, kritikën letrare e çdo gjë tjetër, së cilës iu përkushtua gjithë jetën.

Qoftë i paharruar emri dhe kujtimi i Tij!

Jeta dhe veprimtaria e tij krijuese

Petrit Qejvani me origjinë nga Kallarati i Vlorës, u lind më 1 shkurt 1949 në Gjirokastrë. Gjatë viteve 1968-1972 mbaroi studimet në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë-Letërsi dhe më vonë në vitet 1977-1978 kursin pasuniversitar për Kritikë Letrare. Prej disa vitesh 1973-1987 punoi si mësues letërsie, fillimisht në Kukës e më vonë në Llakatund dhe në disa shkolla të qytetit të Vlorës. Në vitet 1987-1990 për tre vjet kreu detyrën e drejtorit të Teatrit të Vlorës. Më vonë për disa vite punoi drejtor në disa shkolla të qytetit po në Vlorë. Karrierën e tij pedagogjike e mbylli si pedagog pranë Departamentit të



Gjuhë-Letërsisë në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës. Pas një sëmundje të rëndë poeti, prozatori, publicisti, kritikun letrar, Petrit Qejvani më 13 gusht 2014 ndahet nga jeta, duke lënë pas një sërë dorëshkrimesh në poezi, prozë, shkrime publicistike dhe kritikë letrare.

Sa që gjallë poeti, me gjithë këmbënguljen e mjaft prej shokëve, miqve, kolegëve dhe të afërme të tij, nuk pati si qëllim, botimin e krijimtarisë së tij, jo të paktë e shumë të vlerësuar, por të shkruante dhe të pëlqej nga lexuesi i çdo moshe.

Pas vdekjes së tij, ishin vëllezërit, motrat, miqtë, shokët e kolegët që bënë të mundur grumbullimin e krijimtarisë së tij dhe më vonë botimin e tyre.

Pas librit të parë poetik “Kënga e Zogut Blu” shkurt 2015 dhe librit të dytë me publicistikë “Fjala ime” qershor 2016, Petrit Qejvanit (pas vdekjes) me rastin e 75 – vjetorit të lindjes, iu botua libri i tretë “Performancë”, libër i cili u përrua në 3 shkurt 2024 në Tiranë nën kujdesin e z. Mehmet Gëzhilli, drejtor i shtëpisë botuese “Argeta LMG”, botuesit Genti Gëzhilli dhe vëllezërve e motrave të Petritit.

NDAHET NGA JETA MURZIKË SABRI MEMUSHAJ (ÇOBAJ)

Në datën 9 korrik 2024 është ndarë nga jeta Murzika Memushaj, bashkëshortja e Sali Memushaj (ndarë nga jeta), nëna e Ajazit, Bakos, Meritës, Manushaqes e Mimia Memushaj.

Murzika lindi në Kuç më 18 prill 1944 në një familje me ndjenja patriotike dhe atdhetare, nga prindërit Sabri e Selime Çobaj. Në moshën 10 vjeçare mbeti jetim pasi nëna e saj u nda nga jeta në moshë të re. Murzika u martua në Kallaratin në fisin e dëgjuar Memushaj me Sali Memushaj me të cilin lindi, rritën, edukuan e arsimuan me vështirësi të kohës 2 djem e 3 vajza. Murzika së bashku me bashkëshortin Saliun ishin njerëz punëtorë, mikpritës e të sakrificës. Në çdo sektor që punuan në bujqësi e blektorit treguan vlerat më të mira njerëzore, shoqërore e familjare. Murzika ishte një grua e urtë, gojëmbël punëtore, e dashur me njerëzit, grua zonjë e një familjare e shkëlqyer, por edhe një nënë e mirë e një gjyshe e dashur. Kohët e fundit përballoi sëmundje të rëndë e të gjatë nën kujdesin e fëmijëve dhe të afërmeve. Me ndarjen nga jeta të Murzikës, fëmijët humbën njeriun e tyre më të shtrenjtë, por edhe Kallarati humbi një grua zonjë, që i përket brezit të vuajtjeve dhe të punës.

Kryesia e shoqatës u shpreh ngushëllimet më të thella, fëmijëve, nipërve, mbesave dhe fisit Memushaj në Kallaratin e Çobaj në Kuç për humbjen e njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Saj! U prehtë në Paqe!



NDAHET NGA JETA BEQARE SABRI LLANAJ (DEMIRAJ)

Pas një sëmundjeje të gjatë, në datën 17 korrik 2024 u nda nga jeta në moshën 85 - vjeçare, Beqare Llanaj (Demiraj), motra e Budinit (ndarë nga jeta), Lutos, Shefos, Alidisë, Hurmasë, Hismos, Dushit dhe Xhevdet Demiraj, bashkëshortja e Idajet Llanaj (ndarë nga jeta).

Beqaria u lind në Kallaratin më 1 janar 1939 në fisin e dëgjuar Demiraj nga prindërit Sabri e Trëndafilë Demiraj. Ajo u rrit si gjithë fëmijët e tjerë të atij brezi mes vuajtjesh, por me ndjenjën e punës, të sakrificës, të dashurisë dhe respektit njerëzor, cilësi këto të kultivuara te ajo dhe gjithë vëllezërit e motrat nga prindërit e tyre.

Beqaria në moshën 19 vjeçare u martua në fisin e njohur për ndjenjat patriotike dhe atdhetare, Llanaj me Idajet Llanaj me origjinë nga Kallarati. Të dy Idajeti e Beqaria e ndërtuan jetën e tyre në Fier. Shtëpia e tyre në Fier, falë shpirtit të tyre human e njerëzor ishte pritëse për të gjithë kallaratasit dhe jo vetëm.

Ata ishin një çift i përsosur që shprehnin e manifestimin veç respekt e dashuri për njerëzit, në veçanti dashuria për Kallaratin ishte mbi gjithçka. Idajeti u nda para kohe, gati 8 vjet në parë, duke lënë vetëm Beqaren. Por në fakt ajo, ashtu si edhe Idajeti, patën kujdesin maksimal të vajzës së tyre Afërditës, të dhëndërit Bandill Mëzuraj, të nipit Gentit e mbesës Deadës, të cilët u kujdesën për të në mënyrën më të përsosur.

Beqaria ishte një grua zonjë, e dashur, e respektuar me të gjithë, fjalëpak e gojëmbël, mikpritëse. Kudo ku punoi ajo tregoi vlerat më të larta të gruas në shoqëri, në lagje e në komunitet. Në Fier të dy bashkëshortët Idajeti e Beqaria vlerësoheshin për kulturën, për angazhimin në problemet shoqërore, duke lënë një emër të mirë edhe për brezat e ardhshëm dhe një emër të mirë për origjinën e tyre Kallaratin, që ata të dy e deshën aq shumë.

Me ndarjen nga jeta të Beqares, familja, vëllezërit e motrat humbën njeriun e tyre të dashur, Dita nënën e respektuar, Genti e Deada gjyshen e dashur e të mrekullueshme, bashkëshortarët një grua dinjitoze. Ajo do të prehet në vendlindje në Kallaratin së bashku me bashkëshortin Idajetin, duke plotësuar një amanet të tyre, plotësuar nga vajza Afërdita.

Kryesia e Shoqatës Kallarati, shpreh ngushëllimet më të thella familjes, të afërmeve, fisit Demiraj e Llanaj për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur.


Qoftë i paharruar kujtimi i saj! U prehtë në Paqe!



NDAHET PARA KOHE NGA JETA YZEIR AHMET RIBAJ

Në datën 6 gusht 2024 u nda para kohe nga jeta Yzeir Ribaj, bashkëshorti i Haxhiresë, babai i Ladimirit, Florencit e Lena Ribaj, vëllai i Lumturisë (ndarë nga jeta), Sadetes, Athinasë e Tana Ribaj.

Yzeiri u lind në Kallarat më 31 janar 1951 nga prindërit Ahmet e Fëze Ribaj (ndarë nga jeta). Yzeiri u rrit bonjak, pasi në vitin 1966 babai i tij Ahmeti, vdiq në një moshë fare të re 47 vjeç, duke lënë Yzerin vetëm 15 vjeç dhe katër motrat më të vogla. Babai u vdiq kur ata kishim nevojë më shumë se asnjëherë tjetër për të. Në këto kushte barra për të përballuar këtë fatkeqësi të rëndë, i ra nënës së tij Fëzes dhe Yzeirit, si më i madhi i fëmijëve, por edhe si djalë. Por asnjëherë nuk u mungoi ndihma e fisit të tyre Ribaj, bashkëfshatarëve dhe drejtuesve të fshatit të asaj kohe. Duke qenë fëmija i madh i familjes, atij i takoi të fillonte punën në një moshë shumë të re. Kështu në vitin 1968 Yzeirin e mori dajua i tij Nexhip Limaj në NB-në e Kotës, fillimisht si ndihmës traktorist e më vonë traktorist e zetorist. Me qëllim për të qenë më pranë familjes, në fund të vitit 1969 Yzeiri kthehet në SMT-në e Vranishtit si zetorist, ku punoi 25 vjet me radhë në këtë zanat që do ta quante sa të vështirë e të lodhshëm, po edhe aq të bukur, tërheqës e mbi të gjitha mjaft dobiprurës. Yzeir Ribaj, kush nuk e njohu në Kallarat e më gjerë. Një burrë shpatullgjerë, i fuqishëm, hijerëndë e i ashpër në pamjen e parë, por shumë i dashur, zemërgjerë, bujar e mikpritës në brendësi të shpirtit të tij. Njëpunjet punës që bëri si zetorist e traktorist, ai u bë tepër i njohur në tërë Kurveleshin e Poshtëm e Lumin e Vlorës, si njeri punëtor, i ndershëm e zanatçi i shkëlqyer. Në jetë të tërë me zetor e traktor. Me qindra e mijëra ha tokë të pluguar prej tij, me mijëra tonë grurë të shirë me makinë shirëse, me mijëra tonë materiale të mbartura me zetor. Përveçse në Kallarat, Kuç, Bolenë, Vranisht Tërbaç e Smokthinë Yzeiri punoi në Dukat, Sevaster, Novoselë e të tjera vende në



rrethin e Vlorës. Por në mënyrë të veçantë, mbahet mend puna e kryer në kooperativën tonë Kallarat - Bolenë. Yzeiri u martua me Haxhiresën, vajzë nga Vranishti me të cilën lindën, rritën, edukuan e shkolluan tre fëmijë të mrekullueshëm, Ladimirit, Florencin dhe Lenën. Pas viteve 90-të, pikërisht në gusht të vitit 1998, për të qenë pranë fëmijëve, si shumë shqiptarë emigroi në Greqi, por përsëri pa ju ndarë zanatit të tij të vjetër, atij të zetoristit. Por pavarësisht emigrimit, ai asnjëherë nuk i shkëputi marrëdhëniet me vendlindjen, Kallarat, pasi siç shprehej vetë ai "Guri i rëndë peshon në vend të vet".

Sado mirë që të jemi/
Gjumë rehat nuk kemi/
Gjumi që ka lezet/
Në gjirin e nënës së vet.

Gjatë kohës së qëndrimit në Athinë, ishte njeriu që do t'i mblidhte të gjithë bashkëfshatarët e atjeshëm dhe do të drejtonte degën e shoqatës Kallarat në Greqi. Pas disa vitesh emigrimi Yzeiri u kthye në atdhe dhe për shumë vite jetoi pranë djalit në Vlorë, por për asnjë çast i shkëputur nga vendlindja Kallarat. Yzeiri ka dhënë një kontribut të rëndësishëm edhe në funksionimin e grupit artistik të fshatit dhe në mënyrë të veçantë në ndihmën e familjeve kallaratase për ndërtimin r shtëpive të reja. Si në Athinë, ashtu edhe në Kallarat e Vlorë, Yzeiri dha një kontribut të çmuar ndaj vendlindjes, shoqatës "Kallarat" dhe gazetës së saj me shkrime e krijime letrare. Ndarja e tij e parakohshme nga jeta, është një humbje e madhe për familjen, fisin Ribaj dhe Kallarat.

Kryesia e shoqatës "Kallarat" i shpreh familjes, të afërme dhe fisin Ribaj ngushëllimet më të thella e të sinqerta për këtë humbje të parakohshme të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në Paqe!

NDAHET PARA KOHE NGA JETA SHQIPONJA JONUZ FERRAJ (JONUZAJ)

Në datën 13 gusht 2024, mes dhimbjesh e lotësh, kallaratasit morën lajmin e rëndë të ndarjes para kohe nga jeta për shkak të një sëmundjeje të rëndë, të vajzës nga Kallarat, e martuar në Brataj, Shqiponja Jonuz Jonuzaj.

Shqiponja lindi në Kallarat nga prindërit Jonuz e Xhevo Jonuzaj dhe së bashku me 4 motrat e saj: Shefon, Lalenë, Xhilin e Manushaqen u rrit mes vuajtjesh e sakrificave prindërore, u edukua me ndjenjat më të mira të familjes, të fisit Jonuzaj e të Labërisë. Shqiponja u martua në Brataj në fisin e dëgjuar Ferraj me Resmiun dhe kohët e fundit jetonin në Vlorë, ku kishin krijuar një familje të rregullt me tre fëmijët e tyre të mrekullueshëm: Fatjonin, Kasandrën dhe Dilanin. Në kohën kur jeta po u ecte mbarë dhe fëmijët po rriteshin për të dalë në jetë, një sëmundjeje e pashërueshme i ndërpreu në mes jetën, duke e ndarë para kohe nga bashkëshorti, fëmijët, motrat dhe të afërmit.

Në përcjelljen e saj në Brataj morën pjesë shumë njerëz të familjes, të afërm bashkëfshatarët nga Brati, miq e shok të familjes Ferraj. Në përcjelljen e saj morën pjesë edhe një grup grash nga Kallarat, ku njëra prej tyre Bejaze Qejvanaj, mes lotësh e dhimbjesh mbajti fjalën mjaft prekëse të lamtumirës. Kryesia e shoqatës "Kallarat", i shpreh ngushëllimet më të thella, familjes Ferraj, bashkëshortit, fëmijëve, motrave, fisit Ferraj në Brataj e Jonuzaj në Kallarat për ndarjen e parakohshme të njeriut të tyre më të dashur e të shtrenjtë Shqiponjës. Qoftë i paharruar kujtimi i Saj!
U prehtë në Paqe!



NDAHET PARA KOHE NGA JETA ZHANI QEJVANI

Më 22 gusht 2024 u nda nga jeta para kohe Zhani Qejvani, bashkëshortja e Pëllumb Çune Qejvanit me origjinë nga Kallarat.

Ja se si shkruan për të Lefter Qejvani: "Ike pa na thënë lamtumirë e mira kunata jonë Zhani. Ike në një kohë kur bashkshorti jot Pellumbi, vajza Holta dhe djali Aldo kishin më shumë nevojë për ty. Na hidhërove pa masë. Kishim planifikuar që me freskimin e motit t'ju ftonim juve dhe fëmijët të vinit në fshat për të kaluar çaste të bukura, por nuk ishte e thënë të realizohej. Do na mungosh shumë, do na mungojë buzëqeshja jote e sinqertë, o e mira përmetare Zhani. Prehu e qetë pranë vjehrrës Peshqeshes, që e respektove aq shumë. Qofsh e paharruar!

Edhe kryesia e shoqatës "Kallarat" i shpreh familjes së Pëllumb Çune Qejvanaj në Tiranë ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur! Qoftë i paharruar kujtimi i Saj! Ti rrojnë fëmijët! U prehtë në Paqe!



NDAHET NGA JETA BEJDASH MEHMET BEJTAJ

Në datën 19 nëntor 2024 u nda nga jeta në moshën 85 - vjeçare, Bejdash Bejtaj, babai i Lavdoshit, vëllai i Kadifesë, Taros (ndarë nga jeta), Hamidesë, Selimesë (ndarë nga jeta).

Bejdash lindi në Kallarat në vitin 1939, në një familje me ndjenja patriotike, nga prindërit Mehmet e Naze Bejtaj. Ai u rrit mes vuajtjesh e vështirësish si gjithë fëmijët e atyre viteve të luftës e të ndërtimit të vendit. Bejdashi edhe pse në kushtet e vështirësive ekonomike, por edhe gjendjes së tij shëndetësore, përballoi i vetëm jetën nën kujdesin e djalit të tij Lavdoshit, i cili i shërbeu me të gjitha mundësitë deri në fund të jetës.

Kryesia e Shoqatës Kallarat i shpreh ngushëllimet më të thella fisit Bejtaj dhe djalit të tij, për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur.

Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në Paqe!



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA
DINO MAZE BOÇAJ

Në datën 4 shtator 2024 u nda nga jeta në moshën 80 - vjeçare Dino Maze Boçaj, bashkëshorti i Dafinës, babai i Zançes, Engjëllushit, Artës dhe Martinit, vëllai i Muhametit (ndarë nga jeta), Rabos dhe Agronit.

Dinua lindi më 8 maj 1944 në Kallarat në një familje me ndjenja patriotike dhe atdhetare nga prindërit Maze e Peço Boçaj. Ai u rrit si gjithë fëmijët e atij brezi mes vuajtjesh e vështirësish të mëdha, por me ndjenjën e dashurinë për punën. Ai u martua me Dafinën nga Kuçi, edhe kjo nga një familje me tradita të shquara, nga fisi Lalaj. Ata lindën, rritën dhe edukuan katër fëmijë, Zançen, Engjëllushin, Artën dhe Martinin. Dinua i përket brezit të blegtorëve të shquar të Kallaratit që sakrifikuam shumë për zhvillimin e blegtorisë dhe marrjen e rendimenteve të larta sipas kërkesave të asaj kohe. Ai gjithë jetën punoi me ndershmëri e përkushtim në sektorin e blegtorisë, sa në një stan në tjetrin, atje ku kooperativa kishte nevojë, duke sakrifikuar jetën e tij dhe të familjes. Çobanët me të drejtë konsiderohen si më vuajturit e asaj kohe, por mirënjohja dhe vlerësimi për ta nuk ka munguar asnjëherë, ashtu edhe për Dinon, si një prej çobanëve të dalluar të Kallaratit. Dinua kohët e fundit përjetoj sëmundje të gjatë, por gjithmonë nën kujdesin e bashkëshortes dhe të fëmijëve. Dinua ishte një njeri i qetë, i dashur, i urtë, gojëmbël dhe mikpritës. Ai largohet nga jeta duke lënë një emër të mirë, i cili nuk do të harrohet kurrë.



Kryesia e shoqatës "Kallarati" i shpreh familjes, bashkëshortes, fëmijëve, motrës, vëllait dhe fisit Boçaj ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij. U prehtë në Paqe!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA
LUTO SULO MEMUSHAJ

Në datën 2 tetor 2024 u nda nga jeta Luto Sulo Memushaj, vëllai i Ali Memushaj (Dëshmorë i Atdheut), Nexhipit, Saliut, Gjolekës e Kalo Memushaj (ndarë nga jeta), bashkëshorti i Liljanës, babai i Marselës, Teutës, Erjonës dhe Destana Memushaj.

Lutua lindi më 20 prill 1939 në Kallarat në familjen patriote Memushaj nga prindërit Sulo e Belere Memushaj. Fëmijërinë e tij e kaloi mes vështirësive si gjithë fëmijët kallaratas të atyre viteve, por me dëshirën dhe pasionin për dije e arsim. Pasi mbaroi me rezultate të larta shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" në Tiranë, shkoi për studime jashtë vendit në ish Bashkimin Sovjetik, ku mbaroi shkollën e lartë për Inxhinieri Meteorologjie. Më vonë me kthimin në atdhe u diplomua edhe në degën e Historisë e Gjeografisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Lutua shërbeu për një kohë të gjatë si ushtarak në Shkollën e Aviacionit në Vlorë, duke kryer me përkushtim e devotshmëri detyra të ndryshme në fushën e meteorologjisë ushtarake deri sa doli në pension. Për aktivitetin dhe kontributin e tij shumë vjeçarë në shërbim të Forcave të Armatosura është nderuar me urdhra e medalje të ndryshme. Lutua u martua me Lilianën me të cilën lindën, rritën, edukuan e arsimuan me shkollë të lartë katër vajza të mrekullueshme: Marselën, Teutën, Erjonën dhe Destanën. Lutua kishte një dashuri të veçantë për vendlindjen, duke kontribuar ndaj shoqatës "Kallarati" e gazetës së saj. Me ndarjen nga jeta të Lutos, familja, bashkëshortja, vajzat humbën njeriun e tyre më të shtrenjtë, por edhe Kallarati një nga bijtë e tij të denjë. Kryesia e shoqatës "Kallarati" i shpreh familjes, të afërmeve dhe fisit Memushaj ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në Paqe!



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA YLVIE
HASAN VELÇA (MEÇAJ)

Në datën 19 tetor 2024 në Tiranë është përcjellë për në banesën e fundit Ylvie Velça (Meçaj), bashkëshortja e Muhamet Velçës (ndarë nga jeta), motra e Gafurit (ndarë nga jeta) dhe e Hiqmet Meçaj. Ylvia ka lindur në Vlorë më 20 qershor 1934 në familjen Meçaj e dëgjuar për ndjenjat e larta patriotike me origjinë nga Kallarati, nga prindërit Hasan e Kaleme Meçaj. Ajo u martua me Muhamet Hoxha (Velça) më 10 korrik 1954, me të cilin lindën e rritën dy fëmijë, Arturin e Luljanën të cilët për fatin e keq janë ndarë parakohe nga jeta. Ylvia punoi një kohë të gjatë me përkushtim në detyrat e kryera, por me fatkeqësitë e pësuar të ndarjes nga jeta të dy fëmijëve dhe të bashkëshortit, bëri që vitet e fundit të jetës t'i kalonte e dëshpëruar dhe e vetme.



Kryesia e shoqatës u shpreh ngushëllime të afërmeve të saj, fisit Meçaj e Velça për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Saj! U prehtë në Paqe!

IN MEMORIAM


NDAHET NGA JETA HURMA
TAFIL STRATAJ (RIBAJ)

Në datën 13 nëntor 2024 në Tiranë, u nda nga jeta në moshën 88 - vjeçare, Hurma Strataj (Ribaj), bashkëshortja e Xhemalit (ndarë nga jeta) nëna e Natashës, Petritit, Dashnorit (ndarë nga jeta) dhe Leonard Strataj; motra e Caushit, Haxhikes, Drites, Zilidese, Takdiresh, Luljetes e Hekuran Ribaj. Hurmaja u lind në Kallarat të Vlorës më 8 janar 1936 në një familje të varfër, por me ndjenja të theksuara patriotike, liridashëse dhe atdhetare, nga prindërit Tafil e Pajame Ribaj. Ajo u rrit, u edukua nga prindërit e saj me sakrificë dhe me ndjenja të theksuara patriotike e liridashëse. Hurmaja u martua në fisin e dëgjuar për ndjenjat patriotike, Strataj në Kallarat me Xhemal Stratatin. Së bashku me bashkëshortin Xhemalin lindën, rritën, edukuan e arsimuan katër fëmijë: Petritin, Natashën, Dashnorin dhe Leonardin dhe u bënë gjyshër dhe stërgjyshër plot me nipa dhe mbesa duke lënë trashëgimtar të denjë për fisin dhe shoqërinë. Ata ndëruan jetën e tyre fillimisht në qytetin e Vlorës dhe pastaj për një kohë më të gjatë në Fier. Shtëpia e tyre në Fier ishte e hapur në çdo kohë për të afërmit, për bashkëfshatarët e tyre kallaratas, por edhe për miqtë e shokët e tyre e të familjes. Hurmaja, ashtu si edhe bashkëshorti i saj punuan me ndërgjegje, përkushtim e devotshmëri në çdo punë që kreu në Vlorë e Fier, duke qenë shembull, jo vetëm në punë, por edhe në lagje e në qytetin e Fierit. Hurmaja ishte një bashkëshorte e denjë, një nënë e mrekullueshme dhe një vjehrrë e gjyshe e dashur. Ajo ishte fjalëpak dhe shumë e dashur, jo vetëm brenda fisit e miqësisë së familjes, por edhe me komshinjtë, bashkëfshatarët dhe më gjerë. Ajo së bashku me Xhemalin e donte shumë vendlindjen Kallaratit, dashuri të cilën ua kultivuan edhe fëmijëve të tyre. Të dy së bashku kanë dhënë kontribut mjaft të vlerësuar për vendlindjen dhe shoqatën Kallarati. Pas shumë vitesh në qytetin e Fierit, ku si familje ishin mjaft të njohur, në vitin 2004 Hurmaja dhe Xhemali u vendosën në Tiranë pranë djalit Leonardit. Në vitet e fundit të pleqërisë, në kohën e pandemisë në vitin 2020, Hurmasë i ndahet nga jeta bashkëshorti, shoku i jetës, Xhemali, të cilën e përjetoj keq, duke qenë edhe në gjendje shëndetësore jo të mirë. Por ajo që i ndodhi më vonë në vitin 2023 me ndarjen e parakohshme nga jeta të djalit të saj më të vogël, Dashnorit, ishte hidhërimi më i thellë i jetës së saj, të cilën nuk mund t'a kalonte dot si nënë. Prandaj vitet e fundit të pleqërisë, përveç gjendjes së rëndë shëndetësore, edhe pse nën kujdesin e fëmijëve, nuseve, nipërve e mbesave e stërmbesave, i kaloi me shumë vuajtje shpirtërore. Kryesia e Shoqatës Kallarati u shpreh fëmijëve, nipërve e mbesave, fisit Ribaj e Strataj ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi dhe emri i Saj! U prehtë në Paqe!



SAIMIR STRATI, FITUESI I 11 ÇMIMEVE GUINNESS ÇEL EKSPOZITË VETIAKE NË PORTUGALI

Me ftesë të autoriteteve të artit e kulturës vendase, Saimir Strati në muajin shtator 2024 çeli një ekspozitë vetjake në Portugali. Lidhur me pjesëmarrjen e tij në këtë ekspozitë, Saimiri shprehet: “Ndhim i nderuar dhe privilegjuar për ftesën për çeljen e një ekspozite të re në Portugali me rastin e 10-vjetorit të rekordit tim Guinness World Record “Jose Saramago”. Faleminderit për vlerësimin dhe kënaqësinë që më dhuroat”.



ELUS DO SOR
Esta cortiça que nos une
Saimir Strati, "gênio do mosaico" em Ponte de Sor
Ana Beatriz
Saimir Strati, "gênio do mosaico" em Ponte de Sor
Com esta exposição, Strati celebra o seu aniversário de 60 anos e a sua ligação com a comunidade local. A obra é uma homenagem à ponte de Ponte de Sor, construída em 1767, e ao poeta José Saramago, nascido em 1906. A obra é feita com cortiça, um material tradicional português, e é uma homenagem à ponte de Ponte de Sor, construída em 1767, e ao poeta José Saramago, nascido em 1906. A obra é feita com cortiça, um material tradicional português, e é uma homenagem à ponte de Ponte de Sor, construída em 1767, e ao poeta José Saramago, nascido em 1906.



Ës ngado KALLARATI

2025

mos e harro!

| January | | | | | | |
|---------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
| 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | | |

| February | | | | | | |
|----------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | | | | 1 | 2 |
| 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 |
| 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | | |

| March | | | | | | |
|-------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | | | | 1 | 2 |
| 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 |
| 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
| 31 | | | | | | |

| April | | | | | | |
|-------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 |
| 28 | 29 | 30 | | | | |

| May | | | | | | |
|-----|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
| 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 |
| 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | |

| June | | | | | | |
|------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | | | | | 1 |
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 |
| 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 |
| 30 | | | | | | |

| July | | | | | | |
|------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 |
| 28 | 29 | 30 | 31 | | | |

| August | | | | | | |
|--------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | | | 1 | 2 | 3 |
| 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 |
| 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 |

| September | | | | | | |
|-----------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 |
| 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | | | | | |

| October | | | | | | |
|---------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
| 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | | |

| November | | | | | | |
|----------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| | | | | | 1 | 2 |
| 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 |
| 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |

| December | | | | | | |
|----------|----|----|----|----|----|----|
| Mo | Tu | We | Th | Fr | Sa | Su |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 |
| 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | 31 | | | | |

Kryeredaktor:
Lefter HYSAJ

Redaksia e Gazetës:

Anëtarë:

Prof. dr. Rami

MEMUSHAJ,

Hiqmet MEÇAJ,

Fatmir MATAJ,

Çize XHAFERAJ,

Eleni MEMUSHAJ,

Besnik GJONBRATAJ,

Riza MEMUSHAJ,

Selo QEJVANI.

Redaktor/korrektor:

Prof. Dr. Rami Memushaj

Graphic Designer:

A. Hysaj

